



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

RAPORT
(Përfundimtar)

Në lidhje me

**Mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil në institucionet në varësi të
Ministrisë së Drejtësisë**

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E SHËRBIMIT TË PROVËS

Tiranë, Shtator 2018

RAPORT PËRFUNDIMTAR

Për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil në institucionet në varësi të Ministrisë së Drejtësisë:

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës

Hyrje

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11 pika 1, 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar, në zbatim të planit vjetor të mbikëqyrjes dhe të Vendimit nr. 32, datë 16.04.2018, *“Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjit në procesin e administrimit të shërbimit civil, në institucionin e Shërbimit të Provës”*, ka vendosur fillimin e mbikëqyrjes së përgjithshme në lidhje me zbatimin e ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar, në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit të Provës.

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës është pjesë e shërbimit civil, si institucion në varësi të Ministrisë së Drejtësisë dhe funksionon si autoritet përgjegjës për zbatimin e alternativave të dënimit me burgim në Republikën e Shqipërisë, bazuar në kuadrin ligjor në fuqi.

Organizimi dhe funksionimi i Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Provës mbështetet në urdhrin nr. 55, datë 20.04.2017, të Kryeministrit, *“Për miratimin e strukturës dhe organikës së shërbimit të provës”*. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës përbëhet nga Drejtoria e Përgjithshme dhe 22 Zyrat Vendore: Tiranë, Shkodër, Fier, Durrës, Lezhë, Elbasan, Korçë, Berat, Lushnje, Vlorë, Gjirokastrë, Sarandë, Krujë, Kukës, Mat, Dibër, Kavajë, Kurbin, Përmet, Tropojë, Pogradec dhe Pukë.

Me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar, Drejtoria e Përgjithshme të Shërbimit të Provës, përfshihet për herë të parë në skemën e administrimit të shërbimit civil. Përfshirja e saj në *“Listën e institucioneve të administratës shtetërore”*, të cilat janë pjesë e shërbimit civil, është e parashikuar në mënyrë të shprehur në Lidhjen nr. 1 (*numri rendor 84*), të Vendimit nr. 142, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave, *“Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”*, të ndryshuar.

Në bazë të Programit të Mbikëqyrjes, nr. 411/1 prot., datë 16.04.2018, të miratuar nga Komisioneri dhe njoftuar institucionit me shkresën nr. 411/3 prot., datë 16.04.2018, *“Njoftim për fillimin e procesit të mbikëqyrjes së ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil në institucionin e Shërbimit të Provës”*, grupi i punës u paraqit në Drejtorinë së Përgjithshme të Shërbimit të Provës në datën 17.04.2018.

Objekti i mbikëqyrjes është i përgjithshëm dhe përfshin të gjitha institutet e ligjit për nëpunësin civil, ndër të cilat, evidentimin e pozicioneve që kryejnë funksione të shërbimit civil; deklarimin e statusit të punësimit për çdo punonjës të institucionit, në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar; respektimin e kërkesave të

përgjithshme për pranimin në shërbimin civil; hartimin e formularit të përshkrimit të punës; miratimin e planit vjetor të pranimit në shërbimin civil; rekrutimet nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, pas momentit të fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar; transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm; pezullimin nga shërbimi civil; realizimin e vlerësimeve të punës për nëpunësit civil; kryerjen e trajnimeve të detyrueshme për nëpunësit civil në periudhë prove, etj.

Rezulton se, Departamenti i Administratës Publike, bazuar në nenin 7, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, sipas urdhrin nr. 111, datë 11.09.2017, të Drejtorit të Departamentit të Administratës Publike, nga data 13 deri 20 shtator 2017, ka realizuar një inspektim tematik për zbatimin e legjislacionit të shërbimit civil në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit të Provës. Objekti i këtij inspektimi ka qenë respektimi i parashikimeve dhe procedurës ligjore për nëpunësit civil në periudhë prove dhe zbatimi i legjislacionit për shërbimin civil lidhur me institute të veçanta që rregullojnë marrëdhëniet e punës së nëpunësve civilë.

Me shkresën nr. 5446/3 prot., datë 05.02.2018, “Përcillet raporti përfundimtar i inspektimit të zhvilluar në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit të Provës”, Departamenti i Administratës Publike i ka dërguar institucionit raportin përfundimtar të inspektimit të zhvilluar pranë tij.

Më tej, me shkresën nr. 2709/1 prot., datë 23.04.2018, Departamenti i Administratës Publike ka dërguar pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, raportin përfundimtar të këtij inspektimi. Në pjesën III, të raportit në fjalë, janë dhënë edhe rekomandimet përkatëse për institucionin e mbikëqyrur, me qëllim zbatimin e parashikimeve ligjore të përcaktuara në ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar dhe në ligjin nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”.

Në përfundim të procesit të këqyrjes së akteve dhe administrimit të dokumentacionit të nevojshëm në institucion, grupi i punës, i përbërë nga inspektorët Gentiana Biku dhe Ilir Sauli, nën drejtimin e Drejtorit të Mbikëqyrjes, Altin Shumeli, përpunoi të dhënat dhe përgatiti projekt raportin e mbikëqyrjes në lidhje me administrimin e shërbimit civil në këtë institucion.

Me shkresën nr. 411/6 prot., datë 06.07.2018, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, projektraporti i hartuar nga grupi i punës, i është dërguar për njohje institucionit të mbikëqyrur, duke i lënë një afat 15 ditë kohë për të paraqitur observacionet.

Me shkresën nr. 411/7 prot., datë 06.07.2018, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, “Dërgohet projektraporti në përfundim të mbikëqyrjes në institucionin e Shërbimit të Provës, në lidhje me administrimin e shërbimit civil”, projektraporti i mbikëqyrjes i është dërguar për njohje Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Drejtësisë, që është ministria nga e cila varet institucioni i mbikëqyrur.

Me shkresën nr. 411/8 prot., datë 06.07.2018, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, “Dërgohet projektraporti në përfundim të mbikëqyrjes në institucionin e Shërbimit të Provës, në lidhje me administrimin e shërbimit civil”, projekt raporti i mbikëqyrjes i është dërguar për njohje edhe Departamentit të Administratës Publike, në cilësinë e njësisë përgjegjëse në këtë rast.

Subjekti i mbikëqyrur, pasi është njohur me projekt raportin dhe gjetjet e grupit të punës, me shkresën nr. 2997 prot., datë 27.07.2018, “*Observacioni mbi projekt raportin në përfundim të mbikëqyrjes në institucionin e Shërbimit të Provës në lidhje me administrimin e shërbimit civil*”, regjistruar pranë Komisionerit me nr. 411/9 prot., datë 31.07.2018, ka dërguar projekt raportin e nënshkruar nga personat përgjegjës dhe disa pretendime, të cilat janë administruar në dosjen e mbikëqyrjes. Nga përmbajtja e shkresës përcjellëse rezulton se, subjekti i mbikëqyrur është shprehur dakord në përgjithësi me rekomandimet e nxjerra nga grupi i punës, por ka pasqyruar disa sqarime në lidhje me gjetjet në projekt raport, të cilat janë trajtuar në përmbajtjen e raportit përfundimtar, në kapitujt përkatës.

Në këto rrethana, Komisioneri e vlerëson si të përmbushur detyrimin për të njohur subjektin me gjetjet e grupit të mbikëqyrjes dhe çmon se janë kryer të gjitha procedurat e nevojshme që sigurojnë transparencën e procesit dhe mundësinë e institucionit të kontrolluar për të shprehur pretendimet e tij, në lidhje me problematikën e evidentuar. Për këtë arsye, procesi i mbikëqyrjes do të vijojë me dërgimin e raportit përfundimtar dhe të vendimit përkatës për miratimin e tij.

Qëllimi i mbikëqyrjes

Qëllimi i realizimit të mbikëqyrjes është:

- Monitorimi, kontrolli dhe vlerësimi i zbatimit të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, si dhe akteve nënligjore të dala në bazë e për zbatim të tij.
- Paraqitja e konstatimeve dhe fakteve të evidentuara dhe të vlerësuara si parregullsi në lidhje me zbatimin e ligjit për nëpunësin civil para përgjegjësve për administrimin e shërbimit civil, njësisë së burimeve njerëzore dhe titullarit të institucionit.
- Paralajmërimin e institucionit dhe personave përgjegjës, në rast të konstatimi të parregullsive gjatë zbatimit të ligjit, duke lënë edhe detyrat dhe rekomandimet përkatëse për përmirësimin e situatës, brenda një afati të arsyeshëm, sipas përcaktimeve të bëra në nenin 15 të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar.

Objekti i mbikëqyrjes

1. Si është kuptuar dhe zbatuar ligji nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar dhe aktet nënligjore të dala në bazë dhe për zbatim të tij, në lidhje me statusin e punonjësve dhe nëpunësve aktualë të institucionit, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit.
2. Plotësimi i kushteve ligjore të parashikuara në nenin 67, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, në lidhje me statusin e punonjësve dhe nëpunësve aktualë, që do të verifikohet në këto aspekte:
 - Përfshirja e funksionit në shërbimin civil në përputhje me përshkrimin e punës dhe detyrat që realizon ky funksion;
 - Punonjësit ekzistues që janë punësuar në pozicione të shërbimit civil sipas këtij ligji, për një periudhë jo më të vogël se 1 vit;
 - Nëpunësit ekzistues që janë të punësuar në pozicione, pjesë të shërbimit civil sipas këtij ligji, që kanë më pak se një vit në këto pozicione pune;
 - Rastet e refuzimit të deklarimit të statusit të nëpunësit civil;

- Si është dokumentuar në dosjen e personelit procedura e ndjekur nga njësia përgjegjëse, në rastin e verifikimit dhe deklarimit të statusit të punësimit të punonjësve (kërkesat e përgjithshme, kërkesat e posaçme, procedura e rekrutimit, akti i emërimit, etj.).
3. Respektimi i kërkesave ligjore në hartimin e formularit të përshkrimit të punës sipas formatit të përcaktuar nga ligji për nëpunësin civil dhe aktet nënligjore që kanë dalë në zbatim të tij, që do të verifikohet në këto aspekte:
 - Si është zbatuar procedura e hartimit të përshkrimit të punës dhe formati i miratuar me aktin nënligjor përkatës.
 - Verifikimin e faktit nëse punonjësit që janë të emëruar aktualisht në pozicione pune pjesë e shërbimit civil, i plotësojnë kërkesat e përgjithshme të përcaktuara në nenin 21 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.
 - Punonjësit që janë të emëruar aktualisht në pozicione pune pjesë e shërbimit civil, i plotësojnë kërkesat e posaçme, sipas formularit të përshkrimit të punës.
 4. Procedura e ndjekur nga institucioni në lidhje me miratimin e planit vjetor të pranimit në shërbimin civil.
 5. Rastet e rekrutimeve, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, pas momentit të fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.
 6. Respektimi i kërkesave specifike ligjore, gjatë procesit të përmbushjes së periudhës së provës (*detyrimet e nëpunësit dhe procedura e vendimmarrjes në përfundim të kësaj periudhe*).
 7. Transferimi i përkohshëm dhe transferimi i përhershëm dhe si janë respektuar kërkesat ligjore në këto raste (*ristrukturimi dhe ngritja e komisionit përkatës, aktet që materializojnë procesin, si dhe rastet e tjera të transferimit*).
 8. Pezullimi nga shërbimi civil, sipas rasteve të parashikuara në ligj dhe si janë zbatuar kërkesat ligjore gjatë procedurës së zhvilluar në këto raste.
 9. Masat disiplinore dhe respektimi i procedurës ligjore të kërkuar në fazat e zhvillimit të ecurisë disiplinore (kërkesa për fillimin e ecurisë, ngritja e Komisionit të përhershëm).
 10. Vlerësimi i rezultateve në punë dhe si është zhvilluar ky proces pas fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar. Si materializohet procedura e vlerësimit dhe detyrimet ligjore që ligji i ka vendosur aktorëve të këtij procesi gjatë vitit të vlerësimit (*Zyrtari Raportues, Zyrtari Kundërfirmues*).
 11. Përfundimi i marrëdhënies në shërbimin civil për shkak të lirimit nga shërbimi civil: si rezultat i dorëheqjes dhe për shkak të ligjit.
 12. Probleme të ndryshme që i kanë lindur njësisë së menaxhimit të burimeve njerëzore (njësisë përgjegjëse), gjatë punës për zbatimin e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Metodologjia e mbikëqyrjes:

Grupi i mbikëqyrjes ka zgjedhur si metodë pune verifikimin e dokumentacionit që ka lidhje me objektin e mbikëqyrjes, i cili administrohet në dosjet individuale të personelit, në arkivin e

institucionit, si dhe në sektorin e shërbimeve mbështetëse, për çdo nëpunës të emëruar në pozicion pune pjesë e shërbimit civil.

Në zbatim të programit dhe drejtimeve të mbikëqyrjes, grupi i punës ndërmori veprimet e mëposhtme:

- Fillimisht u realizua takimi me Drejtorin e Drejtorisë së Inspektimit dhe Shërbimeve Komunitare dhe Drejtorin e Drejtorisë së Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, gjatë të cilit u diskutua mbi objektin dhe drejtimit e mbikëqyrjes, si dhe u ra dakord në lidhje me dokumentacionin shkresor që duhet të vihej në dispozicion të grupit të mbikëqyrjes për verifikim.
- U verifikuan pozicionet e punës pjesë e shërbimit civil, sipas organigramës dhe strukturës aktuale të institucionit, si dhe sipas strukturës dhe organigramës që ka qenë në fuqi në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar.
- U verifikuan procedurat e rekrutimit dhe përmbajtja e dosjeve individuale të çdo nëpunësi civil, si dhe çdo e dhënë tjetër e kërkuar nga ligji për plotësimin e kërkesave të përgjithshme për pranimin në shërbimin civil.
- U verifikuan përkrahjet e punës për pozicionet e punës pjesë e shërbimit civil, nëse ato janë të hartuara në përputhje me formatin standard të miratuar.
- U verifikuan formularët e vlerësimit të punës në lidhje me vlerësimin e rezultateve në punë për të gjithë nëpunësit civilë të institucionit, dhe, nëse ky proces, është kryer sipas kërkesave të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar.
- U verifikuan të dhënat profesionale, si dhe të dhënat e tjera në lidhje me marrëdhëniet e punës, të çdo nëpunësi, për të provuar përmbushjen e kërkesave të posaçme të vendit të punës, si arsimi, përvoja në punë e të tjera.

Konstatimet janë të materializuara si tabela më vete (*aneks nr. 1, dhe aneks nr. 2*), të cilat janë të organizuara në formën e tabelave dhe janë pjesë e pandarë e këtij raporti.

Përmbajtja e Raportit:

I. Organizimi i shërbimit civil në subjektin e mbikëqyrur

Nga analiza e dokumentacionit të vënë në dispozicion, konstatohet se, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës, në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, (data 26.02.2014), funksiononte mbi bazën e strukturës dhe organikës së miratuar me Urdhrin nr. 100, datë 21.02.2014, të Kryeministrit, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Shërbimit të Provës”. Ky urdhër është shfuqizuar me urdhrin nr. 55, datë 20.04.2017, të Kryeministrit, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Shërbimit të Provës”, i cili është ende në fuqi edhe në momentin e realizimit të kësaj mbikëqyrjeje.

Ashtu si e parashtruam edhe më sipër, ky institucion përbëhet nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës dhe 22 Zyrat Vendore të Shërbimit të Provës: Tiranë, Shkodër, Fier, Durrës, Lezhë, Elbasan, Korçë, Berat, Lushnjë, Vlorë, Gjirokastrë, Sarandë, Krujë, Kukës, Mat, Dibër, Kavajë, Kurbin, Përmet, Tropojë, Pogradec dhe Pukë.

Numri i përgjithshëm i punonjësve në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit të Provës, përfshirë edhe 22 zyrat vendore është gjithsej **148**, të cilët janë të organizuar dhe ndahen në këtë mënyrë:

- ✓ **136** punonjës janë në pozicione pune, që konsiderohen pjesë e shërbimit civil, ose rreth **91 %** të pozicioneve të përgjithshme të punës.
- ✓ **12** punonjës janë në pozicione pune që kryejnë funksione administrative, ose **9%** e pozicioneve të përgjithshme të punës.

Duke vlerësuar klasifikimin e pozicioneve në shërbimin civil, sipas përcaktimeve të nenit 19, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar dhe Vendimit nr. 142, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, të ndryshuar me Vendimin nr. 262, datë 25.03.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për disa ndryshime në Vendimin nr. 142, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, **136** pozicionet e punës, pjesë e shërbimit civil në këtë institucion, paraqiten në këtë raport:

- Nëpunës civilë të nivelit të lartë drejtues, është **1** pozicion pune, ose rreth **1 %** e pozicioneve të punës pjesë e shërbimit civil, ku përfshihet titullari i institucionit.
- Nëpunës civilë të nivelit të mesëm drejtues, janë **25** pozicione pune, ose rreth **18 %** e pozicioneve të punës pjesë e shërbimit civil, të cilat i përkasin pozicionit “Drejtor”.
- Nëpunës civilë të kategorisë ekzekutive, janë **110** pozicione pune, ose rreth **81 %** e pozicioneve të punës pjesë e shërbimit civil, të cilat i përkasin pozicionit “Inspektor/Specialist”.

Nga analiza e pozicioneve në shërbimin civil konstatohet se, struktura dhe organika e miratuar për institucionin e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Provës, parashikon qartësisht hierarkinë e shërbimit civil. Në nenin 18, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, përcaktohet se institucionet e varësisë drejtohen dhe përfaqësohen nga drejtori, në rastin konkret Drejtori i Përgjithshëm, i cili raporton tek ministri përgjegjës. Klasifikimi i pozicioneve të shërbimit civil në kategorinë e lartë drejtuese, të mesme drejtuese dhe ekzekutive, është parashikuar në nenin 19, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Në mbështetje të kësaj dispozite, ka dalë vendimi nr. 142, datë 12.03.2014, i Këshillit të Ministrave, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, i ndryshuar, ku në pikën 5, të Kreut II, ka përcaktuar klasat e zbatueshme për secilën kategori të shërbimit civil, si dhe emërtesën e pozicioneve të punës që i përkasin secilës klasë.

Konstatohet se përgjegjësitë dhe detyrat kryesore mbi të cilat funksionon secili pozicion pune në këtë institucion, janë përcaktuar në Rregulloren e Brendshme të Shërbimit të Provës, miratuar me vendimin nr. 302, datë 25.03.2009, “Për organizimin e funksionimin e Shërbimit të Provës dhe për përcaktimin e standardeve e të procedurave, për mbikëqyrjen e ekzekutimit të dënimeve alternative” dhe aktualisht mungojnë përshkrimet e punës për pozicionet që janë pjesë e shërbimit civil. Rezulton se në rregulloren e brendshme në fuqi, nuk janë pasqyruar ndryshimet që kanë ndodhur në organizimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Provës, e po kështu nuk është përshtatur, për të qenë në koherencë me ligjin për nëpunësin civil.

Në mënyrë të detajuar, kjo gjendje është pasqyruar në tabelën **Aneks nr. 1** - “Aktet që materializojnë procesin e njohjes së statusit për nëpunësit që punojnë në pozicione të shërbimit civil, në momentin e mbikëqyrjes)”, e cila është pjesë përbërëse e këtij raporti.

➤ **Konstatim:**

Gjatë verifikimit të thelluar të përmbajtjes së strukturës organizative të institucionit, të miratuar me urdhrin nr. 55, datë 20.04.2017, të Kryeministrit, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Shërbimit të Provës”, në Skemën 2/1, “Organika e Zyrës Vendore të Shërbimit të Provës, Tiranë”, konstatohet se, pozicioni i punës “Arkivist”, nuk është vlerësuar si pjesë e shërbimit civil.

Në kuptim të nenit 2, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, ky pozicion pune ka qenë dhe vijon të mbesë pjesë e shërbimit civil, në kushtet kur realizon një funksion publik. Për më tepër, përfshirja e këtij pozicioni në shërbimin civil është përcaktuar edhe në Vendimin nr. 142, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, të ndryshuar me Vendimin nr. 262, datë 25.03.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për disa ndryshime në Vendimin nr. 142, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”.

Konkretisht, në pikën 9 të këtij akti nënligjor, klasifikohen pozicionet e shërbimit civil të kategorisë ekzekutive, sipas natyrës së pozicionit në a) grupet e pozicioneve të administrimit të posaçëm dhe b) grupin e pozicioneve të administrimit të përgjithshëm.

Ndërkohë, sipas pikës 12 të këtij akti nënligjor, grupet e pozicioneve të administrimit të posaçëm përcaktohen në Lidhjen nr. 3, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e tij.

Më tej, Lidhja nr. 3, “Klasifikimi i pozicioneve të punës sipas grupeve të ngjashme të punës/sipas profesioneve të punës”, në kolonën e parë, ka renditur grupin e specialistëve të institucioneve të administratës publike, që përfshihen në fushën e veprimit të ligjit për shërbimin civil, bazuar mbi profesionet përkatëse. Në këtë renditje, rezulton se në grupin që i përket ndarjes me numër rendor 26, përcaktohet në mënyrë të shprehur emërtesa e pozicionit të punës “Specialistë të Arkivave”, si pozicione që përfshihen në fushën e veprimit të ligjit të shërbimit civil.

Konkluzion:

Nga sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, pozicioni i punës “Arkivist”, pranë Zyrës Vendore të Shërbimit të Provës, Tiranë duhet të konsiderohet si pozicion pune pjesë e shërbimit civil, nga ana e njësisë përgjegjëse, Departamentit të Administratës Publike dhe të reflektohet në strukturën e institucionit.

II. Statusi i punonjësve dhe nëpunësve aktualë, të gjendur në pozicione të shërbimit civil, në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit, (data 26.02.2014) dhe si janë zbatuar procedurat gjatë procesit të deklarimit të statusit të punësimit

Neni 67, i ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në nëntitullin “Statusi i punonjësve dhe nëpunësve aktualë”, e konkretisht në pikën 3, 4 dhe 6, të kësaj dispozite, parashikon rregullimin e statusit për nëpunësit dhe punonjësit që në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit, kryenin detyra në vende pune të konsideruara pjesë e shërbimit civil, duke i kategorizuar si,

- ✓ “Nëpunës civilë ekzistues, punonjësit ekzistues, që janë të punësuar në pozicione të shërbimit civil, sipas këtij ligji dhe që janë rekrutuar sipas një procedure pranimi konkurruese, të ngjashme me atë të përcaktuar nga ligji nr. 8549, datë 11.11.1999, “Statusi i nëpunësit civil”, apo që janë të punësuar në të njëjtin vend pune për një periudhë jo më të vogël se 1 vit, janë, për shkak të ligjit, nëpunës civilë”;
- ✓ “Nëpunës ekzistues, ata punonjës që janë të punësuar në pozicione pune, pjesë e shërbimit civil, sipas këtij ligji dhe që nuk plotësojnë kushtet e parashikuara në pikën 3 të këtij neni, janë nëpunës civilë në periudhë prove dhe për ta zbatohen dispozitat e nenit 24 të këtij ligji. Periudha e provës fillon nga fillimi i shtrirjes së efekteve të këtij ligji”;

Ndërkohë, në këtë dispozitë, përcaktohet njësia përgjegjëse, si struktura që ngarkohet me detyrimin për të deklaruar statusin e punësimit, sipas kategorive të evidentuara më sipër, pas verifikimit të procedurës së punësimit.

Më tej, kjo procedurë rregullohet hollësisht nëpërmjet vendimit nr. 116, datë 05.03.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil, sipas ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar në pikën 1, të Kreut III, “Statusi i punonjësve ekzistues në institucionet e administratës shtetërore dhe komnat”, përcakton se:

“Punonjës ekzistues”, sipas pikës 3 të nenit 67 të ligjit nr. 152/2013, që kryejnë funksione të shërbimit civil në institucionet e administratës shtetërore e komuna, dhe a) janë rekrutuar sipas procedurave të ngjashme me ato të përcaktuara nga ligji nr. 8549, datë 11.11.1999, “Statusi i nëpunësit civil”, por që nuk e gëzojnë statusin e nëpunësit civil; apo b) janë të punësuar në të njëjtin vend pune për një periudhë jo më të vogël se 1 vit, janë nëpunës civilë për shkak të ligjit”.

Dispozitat e sipërpërmendura, përbëjnë kuadrin ligjor të zbatueshëm për deklarimin e statusit të punësimit, pas verifikimit të procedurës së punësimit, për të gjithë nëpunësit që mbanin pozicione pune të shërbimit civil, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar.

Mbështetur në këtë bazë ligjore, për të arritur në një konkluzion të saktë lidhur me veprimet e kryera nga strukturat përgjegjëse për administrimin e shërbimit civil, (njësia e burimeve njerëzore e institucionit, Sekretari i Përgjithshëm i ministrisë nga e cila varet institucioni i mbikëqyrur dhe njësia përgjegjëse, DAP), nëse veprimet e tyre janë kryer në përputhje me

kërkesat e ligjit për deklarimin e statusit të punësimit, grupi i mbikëqyrjes verifikoi dhe analizoi të gjitha materialet shpresore që përmbajnë të dhëna lidhur me pozicionet e shërbimit civil, të tilla si:

- strukturën dhe organikën e institucionit që ishte në fuqi në datë 26.02.2014;
 - listë prezencën dhe listë pagesën e punonjësve për muajin shkurt 2014 dhe ato aktuale në momentin e mbikëqyrjes;
 - dosjen individuale të çdo punonjësi të punësuar në pozicione të shërbimit civil (*aktet e emërimit, të dhënat lidhur me nivelin e diplomës dhe profilin e arsimit të lartë për çdo punonjës të punësuar në pozicione të shërbimit civil*);
 - si dhe të faktit nëse punonjësit që punojnë në pozicione pune që janë pjesë e shërbimit civil, i plotësojnë ose jo, kërkesat e përgjithshme e të posaçme për pranimin në shërbimin civil, sipas ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.
- o ***Zbatimi i ligjit gjatë procesit të deklarimit të statusit të punësimit në raport me kohë zgjatjen e punësimit dhe plotësimin e kërkesave specifike të pozicionit të punës nga punonjësit, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar***

Bazuar në ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, neni 4, shkronja “f”, Departamenti i Administratës Publike, paraqitet si njësi përgjegjëse për institucionin e mbikëqyrur. Ligji për nëpunësin civil dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, e ngarkojnë njësinë përgjegjëse (DAP-in), me disa detyra dhe përgjegjësi, në kuadër të garantimit të një shërbimi civil të qëndrueshëm.

Një nga detyrat që ligji i ngarkon njësisë përgjegjëse në momentin e implementimit të ligjit aktual për nëpunësin civil, është deklarimi i statusit të punësimit, për të gjithë nëpunësit dhe punonjësit të cilët në datën e fillimit të efekteve të ligjit, ishin të punësuar në pozicione të shërbimit civil.

Më konkretisht, pika 6, e nenit 67, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, përcakton se, “*Deklarimi i statusit të punësimit, sipas pikave 1, 3 dhe 4 të kësaj dispozite, bëhet nga njësia përgjegjëse pas verifikimit të procedurës së punësimit*”.

Më tej, në mbështetje të pikës 8, të nenit 67, të ligjit, është miratuar vendimi nr. 116, datë 05.03.2014 i Këshillit të Ministrave, “*Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në përmbajtjen e të cilit janë përcaktuar procedurat e hollësishme që duhet të kryejë njësia përgjegjëse, për të realizuar deklarimin e statusit të punësimit për punonjësit dhe nëpunësit aktualë.*

Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion konstatohet se:

Në zbatim të akteve rregullative si më sipër, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore pranë institucioneve të mbikëqyrur, pasi ka evidentuar pozicionet e punës pjesë e shërbimit civil, i ka dërguar njësisë përgjegjëse, Departamentit të Administratës Publike, me shkresën nr. 568/1 prot.,

datë 23.06.2014, “Dërgim informacioni mbi verifikimin e statusit të nëpunësve aktualë të Shërbimit të Provës”, listën e plotë të punonjësve si edhe materialet që përmbanin të dhëna lidhur me mënyrën dhe kohëzgjatjen e punësimit; aktet individuale të emërimit, si dhe materialet shkresore me të dhënat individuale të çdo punonjësi të punësuar në pozicione pune pjesë e shërbimit civil.

Departamenti i Administratës Publike pas marrjes së dokumentacionit të mësipërm, për çdo të punësuar në pozicione të shërbimit civil, ka verifikuar periudhën e punësimit, nëse ishte më shumë se një vit apo më pak se një vit, si dhe plotësimin e kërkesave të përgjithshme dhe të kërkesave të posaçme për vendin e punës dhe në përfundim të këtyre verifikimeve ka përfunduar dhe procedurën e deklarimit të statusit të punësimit për të gjithë punonjësit. Në këtë rast, situata paraqitet si më poshtë:

Në momentin e mbikëqyrjes Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës, ashtu si e përmendëm edhe më sipër, është e organizuar dhe funksionon mbi bazën e strukturës dhe organikës së miratuar me Urdhrin nr. 55, datë 20.04.2017, të Kryeministrit, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Shërbimit të Provës”. Sipas kësaj strukture ky institucion ka gjithsej **148** pozicione pune, nga të cilat, **136 pozicione pune janë vlerësuar nga njësia përgjegjëse, si pjesë e shërbimit civil.**

Në lidhje me aspekte të administrimit të burimeve njerëzore, që kanë të bëjnë me momentin e deklarimit të statusit të punësimit, për nëpunësit e institucionit, të cilët hyrja në fuqi e ligjit për nëpunësin civil i gjeti në pozicione pune pjesë e shërbimit civil; me punonjësit që aktualisht punojnë në pozicione pune që janë pjesë e shërbimit civil dhe janë rekrutuar rishtazi; si dhe me pozicionet që janë ende të paplotësuara, situata në Drejtorinë e Përgjithshme e Shërbimit të Provës në momentin e mbikëqyrjes paraqitet si më poshtë:

- ✓ *Në 25 raste*, nga njësia përgjegjëse është bërë deklarimi i statusit të punësimit si “nëpunës civilë”, për punonjës të punësuar në të njëjtin vend pune për një periudhë më shumë se një vit.
- ✓ *Në 1 rast*, nga njësia përgjegjëse nuk është bërë deklarimi i statusit të punësimit si “nëpunës civilë”, për punonjës të punësuar në të njëjtin vend pune për një periudhë më shumë se një vit.
- ✓ *Në 37 raste*, nga njësia përgjegjëse është bërë deklarimi i statusit të punësimit si “nëpunës civilë në periudhë prove”, për punonjës të punësuar në të njëjtin vend pune për një periudhë më të vogël se një vit.
- ✓ *Në 3 raste* nga njësia përgjegjëse janë zbatuar vendime gjyqësore.
- ✓ *Në 4 raste*, nga njësia përgjegjëse nuk ka realizuar përfundimin e marrëdhënies së punësimit, në kushtet kur punonjësit nuk plotësojnë kriteret për të qenë nëpunës civil
- ✓ *Në 3 raste*, nga njësia përgjegjëse është zhvilluar procedura e pranimit në shërbimin civil, sipas kërkesave të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, pas fillimit të efekteve të ligjit për nëpunësin civil.

- ✓ Në 50 raste, janë kryer emërimet me kontratë, pas hyrjes në fuqi të ligjit për nëpunësin civil, në kundërshtim me kërkesat e tij.
- ✓ Në 13 raste, pozicionet e punës, janë të lira.

Në vijim të raportit, këto kategori do të analizohen në mënyrë të detajuar.

Nga verifikimi i akteve të emërimit të çdo punonjësi të punësuar në pozicione të shërbimit civil dhe këqyrja e shënimeve në librezën e punës, lidhur me momentin e fillimit të marrëdhënies së punës dhe kohëzgjatjen e punësimit, për efekt të llogaritjes së kategorizimit të punonjësve në momentin e deklaramit të statusit të punësimit, konstatohet kjo situatë:

- Punonjës të punësuar për një periudhë më shumë se një vit, janë konstatuar 25 raste, për të cilët është deklaruar statusi i punësimit

Në lidhje me këtë kategori të punonjësve u konstatua se për të gjitha rastet është realizuar procesi i deklaramit të statusit të punësimit për punonjësit ekzistues, të punësuar në të njëjtin vend pune, për një periudhë më tepër se 1 vit, me statusin e punësimit "nëpunës civil" dhe bëhet fjalë për punonjësit e identifikuar më poshtë:

*****,
 *****,
 *****,
 ***** dhe

Për të gjithë punonjësit e këtij grupimi, në momentin e kryerjes së mbikëqyrjes, vazhdon marrëdhënia e punës me institucionin, duke ruajtur të njëjtin status dhe të njëjtin vend pune.

Konkluzion: Nga verifikimi i dokumentacionit përkatës, në lidhje me deklaramin e statusit të punësimit, Komisioneri vlerëson se:

- Procedurat e deklaramit të statusit të punësimit "nëpunës civil", për punonjësit e përmendur më sipër, janë kryer në respektim të kërkesave të nenit 67, pika 3, të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar.
- Këta punonjës, në datën 26 Shkurt 2014, ishin të punësuar në pozicione pune pjesë e shërbimit civil, kohëzgjatja e periudhës së punësimit ishte më e madhe se një vit dhe ata plotësojnë kriterin e nivelit arsimor të diplomës së arsimit të lartë, për pozicionin përkatës të punës.
- Nga këqyrja dhe analiza që i është bërë akteve të emërimit, nivelit të diplomës së arsimit të lartë për pozicionet përkatëse të punës dhe momentit të fillimit të marrëdhënies financiare, rezulton e vërtetuar se, në të gjitha këto raste, këta punonjës, në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, kanë pasur më shumë se një vit vjetërsi, në detyrën që mbanin në datën 26.02.2014.
- Për këtë kategori nëpunësish, me të drejtë njësia përgjegjëse ka nxjerrë aktin e deklaramit të statusit të punësimit, si "nëpunës civilë", nëpërmjet vendimeve përkatëse të nxjerra, në muajin Tetor 2014, të cilat janë të pasqyruara në mënyrë të detajuar në **Aneksin nr. 1**

– “Aktet që materializojnë procesin e njohjes së statusit për nëpunësit që punojnë në pozicione të shërbimit civil, në momentin e mbikëqyrjes”, i cili është pjesë përbërëse e këtij raporti.

➤ **Konstatim:**

Gjatë procesit të mbikëqyrjes, konstatohet **1 rast**, kur nga ana e njësisë përgjegjëse (DAP) nuk është deklaruar statusi i punësimit si “nëpunës civil”, për një punonjëse të punësuar në një vend pune për një periudhë më shumë se një vit, në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, (data 26.02.2014).

Konkretisht, bëhet fjalë për rastin e punonjësës *****, e cila rezulton se ka filluar punë me urdhrin nr. 343, datë 25.09.2009, të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit të Provës, në pozicionin e punës, “Specialiste, në Zyrën Vendore të Shërbimit të Provës, Tiranë”.

Më pas, me urdhrin nr. 2164, datë 31.12.2013, të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit të Provës, rezulton se kjo punonjëse ka kaluar në pozicionin e punës, “Përgjegjës Sektori, në Zyrën Vendore të Shërbimit të Provës, Tiranë”.

Konstatohet se, Departamenti i Administratës Publike, gjatë procesit të deklarimit të statusit të punësimit, me shkresën nr. 1646/9 prot., datë 30.10.2014, ka vënë në dijeni institucionin e mbikëqyrur se, pas verifikimit të procedurës për dhënien e statusit lidhur me rastin e punonjësës *****, në pozicionin e punës, “Përgjegjës Sektori, në Zyrën Vendore të Shërbimit të Provës, Tiranë”, nuk mund të shprehet për deklarimin e statusit të punësimit, pasi pozicioni në fjalë nuk rezulton në strukturën e institucionit (Urdhri nr. 100, datë 21.02.2014, të Kryeministrit, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Shërbimit të Provës”) në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit për nëpunësin civil.

Nga dokumentacioni i administruar rezulton se kjo punonjëse, në datën 26.02.2014, efektivisht ka qenë e punësuar në pozicionin e punës “Specialiste, në Zyrën Vendore të Shërbimit të Provës, Tiranë”, i cili është pjesë e shërbimit civil; kohëzgjatja e periudhës së punësimit ka qenë më e madhe se një vit dhe ajo plotëson kriterin e nivelit arsimor të diplomës së arsimit të lartë, për pozicionin përkatës të punës, ç`ka do të thotë se i përmbush kërkesat e nenit 67/3, të ligjit për nëpunësit civil.

Fakti që në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit për nëpunësin civil, ende nuk ishte implementuar struktura e miratuar me Urdhrin nr. 100, datë 21.02.2014, të Kryeministrit, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Shërbimit të Provës”, nuk mund të penalizojë punonjësen në fjalë. Konstatohet se, pas riorganizimit të institucionit, me strukturën e re, kjo punonjëse ka vijuar të kryejë detyrën në pozicionin e punës, “Specialiste, në Zyrën Vendore të Shërbimit të Provës, Tiranë” dhe ende vijon të kryejë këtë detyrë në momentin e realizimit të mbikëqyrjes.

Për këtë arsye, në kushtet kur njësisë përgjegjëse në këtë rast ende nuk është shprehur për statusin e punësimit në raport me shërbimin civil të punonjësës në fjalë, duhet që të finalizojë procesin e deklarimit të statusit të punësimit, për punonjësen *****, në pozicionin e punës ku ajo ka qenë në momentin e zbatimit të strukturës së re.

Konkluzion: Në këto rrethana, Komisioneri vlerëson se, njësia përgjegjëse (DAP), duhet të shprehet në lidhje me deklarinimin e statusit të punësimit “nëpunës civil”, për punonjësen *****, në pozicionin e punës, “*Specialiste, në Zyrën Vendore të Shërbimit të Provës, Tiranë*”, në zbatim të kërkesave të nenit 67, pika 3, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar.

- Në kategorinë e punonjësve të punësuar për një periudhë më pak se një vit, janë konstatuar 37 raste, për të cilët është deklaruar statusi i punësimit

Në lidhje me këtë kategori të punonjësve u konstatua se në këtë rast është realizuar procesi i deklarimit të statusit të punësimit “nëpunës civil në periudhë prove”, për 37 punonjës ekzistues, të punësuar në të njëjtin vend pune, për një periudhë më pak se 1 vit, dhe bëhet fjalë për punonjësit e renditur më poshtë:

✓ *****,
*****,
*****,
*****,
*****,
*****,
***** dhe
*****.

Këta punonjës, në datën 26 Shkurt 2014, ishin të punësuar në një pozicion pune pjesë e shërbimit civil, kohëzgjatja e periudhës së punësimit ishte më pak se një vit dhe ata e plotësojnë kriterin e nivelit arsimor të diplomës së arsimit të lartë, për pozicionin përkatës të punës.

Nga verifikimi i aktit të emërimit, nivelit të diplomës së arsimit të lartë për pozicionin përkatës të punës dhe momentit të fillimit të marrëdhënieve financiare, rezulton e vërtetuar se, në këtë rast, këta punonjës, në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, kanë pasur më pak se një vit vjetërsi, në detyrën që mbanin në datën 26.02.2014.

Për këta punonjës, në momentin e kryerjes së mbikëqyrjes, vazhdon marrëdhënia e punës me institucionin, duke ruajtur të njëjtin pozicion pune.

Procedura e deklarimit të statusit të punësimit “Nëpunës civil në periudhë prove”, për punonjësit e mësipërm është kryer në respektim të kërkesave të nenit 67, pika 4, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar.

Për këtë kategori nëpunësish, me të drejtë njësia përgjegjëse ka nxjerrë aktin e deklarimit të statusit të punësimit, si “nëpunës civil në periudhë prove”, nëpërmjet vendimit të muajit tetor, 2014, ashtu si pasqyrohet në mënyrë të detajuar në **Aneksin nr. 1** – “*Aktet që materializojnë procesin e njohjes së statusit për nëpunësit që punojnë në pozicione të shërbimit civil, në momentin e mbikëqyrjes*”, i cili është pjesë përbërëse e këtij raporti.

Për këto raste ka përfunduar periudha e provës dhe është realizuar programi i trajnimit të detyrueshëm për nëpunësit civilë. Në dosjen e këtyre nëpunësve është e administruar certifikata përkatëse e lëshuar nga Shkolla e Administratës Publike (ASPA) dhe vlerësimi i rezultateve në punë për periudhën e provës, por në momentin e mbikëqyrjes rezultonte se ende nuk ishte finalizuar procesi i konfirmimit në përfundim të periudhës së provës.

Këtë fakt e kishte konstatuar edhe Departamenti i Administratës Publike në raportin përfundimtar të inspektimit të zhvilluar në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit të Provës, duke argumentuar se në kundërshtim me dispozitat ligjore titullari i institucionit nuk ka marrë masat e nevojshme për konfirmimin e nëpunësve civilë në periudhë prove, sipas parashikimeve të nenit 24, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe ka rekomanduar të përmbillet ky proces në përputhje me ligjin.

Bashkëlidhur shkresës nr. 2997/2 prot., datë 27.07.2018, “*Observacioni mbi projektraportin në përfundim të mbikëqyrjes në institucionin e Shërbimit të Provës në lidhje me administrimin e shërbimit civil*”, regjistruar pranë Komisionerit me nr. 411/9 prot., datë 31.07.2018, institucioni i mbikëqyrur ka dërguar vendimet e konfirmimit pas përfundimit të periudhës së provës, për 37 nëpunës civilë, për të cilët kishte përfunduar periudha e provës.

Konkluzion:

Komisioneri vlerëson se, procedura e periudhës së provës ka përfunduar në përputhje me kërkesat e nenit 24, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore në institucionin e mbikëqyrur ka vepruar drejt në lidhje me deklarinimin e statusit të punësit si nëpunës civilë në periudhë prove, pasi këta punonjës i përmbushin kushtet e parashikuara në nenin 67, pika 4, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe në aktet nënligjore që kanë dalë në bazë dhe për zbatim të tij.

Vendimet e konfirmimit, pas përfundimit të periudhës së provës, i janë njoftuar Departamentit të Administratës Publike, në cilësinë e njësisë përgjegjëse për këtë institucion dhe si organi kompetent për administrimin e Regjistrimit Qendror të Personelit.

- Rastet kur nga njësia përgjegjëse janë plotësuar pozicione pune pjesë e shërbimit civil në zbatim të vendimeve gjyqësore

Gjatë procesit të mbikëqyrjes, konstatohet se, nga ana e njësisë përgjegjëse, (DAP), në përputhje me Urdhrin nr. 5151, datë 28.10.2015, “Për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë nga institucionet e administratës shtetërore të përfshira në fushën e zbatimit të ligjit për shërbimin civil”, të Ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, i cili ende vijon të jetë në fuqi, janë kryer emërimet në shërbimin civil në zbatim të vendimeve gjyqësore dhe bëhet fjalë për punonjësit e renditur më poshtë:

1. ******, në pozicionin e punës, “Inspektor, në Sektorin e Inspektimit në Drejtorinë e Inspektimit dhe Shërbimeve Komunitare”, emëruar nga DAP me aktin nr. 383/1, datë 22.06.2017, në zbatim të vendimit nr. 1540 (199), datë 25.06.2015, të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

2. *****, në pozicionin e punës, “*Specialist, në Zyrë Vendore të Shërbimit të Provës, Tiranë*”, emëruar nga DAP me aktin nr. 5104/1, datë 29.08.2017, në zbatim të vendimit nr. 2853, datë 22.06.2017, të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.
3. *****, në pozicionin e punës, “*Drejtor i Zyrës Vendore të Shërbimit të Provës, Kukës*”, emëruar nga DAP me aktin nr. 3129/1, datë 01.06.2017, në zbatim të vendimit nr. 96, datë 19.01.2017, të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

➤ Rastet kur nuk ka përfunduar marrëdhënia e punës, në kushtet kur punonjësit nuk plotësojnë kriteret për të qenë nëpunës civil

Gjatë procesit të mbikëqyrjes, konstatohet se, Departamenti i Administratës Publike, me shkresën nr. 1646/4 prot., datë 30.10.2014, ka vënë në dijeni institucionin e mbikëqyrur se pas verifikimit të procedurës për dhënien e statusit, ka rezultuar se për disa raste, megjithëse pozicionet e punës vlerësohen si pjesë në shërbimin civil, janë emëruar punonjës të cilët nuk plotësojnë kriteret për të qenë nëpunës civilë, në pozicionet përkatëse.

Po kështu, Departamenti i Administratës Publike në raportin përfundimtar të inspektimit të zhvilluar në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit të Provës, ka konstatuar se në kundërshtim me dispozitat ligjore dhe me shkresën e mësipërme, nuk janë ndërprerë marrëdhëniet e punës si pasojë e mosplotësimit të kriterëve për të qenë nëpunës civilë në pozicionet përkatëse në shërbimin civil.

Në momentin e mbikëqyrjes rezultoi se, 4 punonjës, të cilët nuk plotësojnë kriteret për të qenë nëpunës civilë, vazhdonin ende në këto pozicione pune të shërbimit civil dhe konkretisht, bëhet fjalë për punonjësit:

- ✓ *****, në pozicionin e punës, “*Drejtor i Zyrës Vendore të Shërbimit të Provës, Sarandë*”, emëruar sipas urdhrin nr. 132/15, datë 25.02.2014, të Ministrit të Drejtësisë.
- ✓ *****, në pozicionin e punës, “*Drejtor i Zyrës Vendore të Shërbimit të Provës, Shkodër*”, emëruar sipas urdhrin nr. 838/1, datë 18.12.2013, të Ministrit të Drejtësisë.
- ✓ *****, në pozicionin e punës, “*Drejtor i Zyrës Vendore të Shërbimit të Provës, Përmet*”, emëruar sipas urdhrin nr. 132/6, datë 25.02.2014, të Ministrit të Drejtësisë.
- ✓ *****, në pozicionin e punës, “*Drejtor i Zyrës Vendore të Shërbimit të Provës, Vlorë*”, emëruar sipas urdhrin nr. 132/13, datë 25.02.2014, të Ministrit të Drejtësisë.

Në lidhje me këtë aspekt të konstatuar në projekt raport, bashkëlidhur observacioneve të dërguara nga institucioni i mbikëqyrur, janë dërguar urdhrat mbi përfundimin e marrëdhënieve të punës për 3 punonjës, të cilët nuk i plotësojnë kriteret për të qenë nëpunës civilë. Konkretisht bëhet fjalë për punonjësit si më poshtë:

- ✓ *****, në pozicionin e punës, “*Drejtor i Zyrës Vendore të Shërbimit të Provës, Sarandë*”, janë ndërprerë marrëdhëniet financiare me urdhrin nr. 2981/1, datë 26.07.2018, të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit të Provës.

- ✓ *****, në pozicionin e punës, “Drejtor i Zyrës Vendore të Shërbimit të Provës, Shkodër”, janë ndërprerë marrëdhëniet financiare me urdhrin nr. 2959, datë 25.07.2018, të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit të Provës.
- ✓ *****, në pozicionin e punës, “Drejtor i Zyrës Vendore të Shërbimit të Provës, Përmet”, janë ndërprerë marrëdhëniet financiare me urdhrin nr. 2982, datë 26.07.2018, të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit të Provës.

Konkluzion: Komisioneri vlerëson se, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit të mbikëqyrur, ka reaguar në **3** raste, duke marrë masa për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës për punonjësit, ***** dhe ***** të cilët nuk e përmbushin kriterin për të qenë nëpunës civilë, në përputhje me kërkesat e nenit 67, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe Vendimit nr. 116, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

➤ Lidhur me rastin e punonjësit ***** në pozicionin e punës, “Drejtor i Zyrës Vendore të Shërbimit të Provës, Vlorë”, emëruar sipas urdhrit nr. 132/13, datë 25.02.2014, të Ministrit të Drejtësisë, i cili nuk e përmbushte kriterin e vjetërsisë në punë për këtë pozicion pune, konstatohet se ai vijon ende në këtë detyrë.

Nga ana e institucionit, është dërguar së bashku me observacionet, vendimi i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, e cila me vendimin e ndërmjetëm të datës 24.05.2018, ka pranuar kërkimin e paditësit ***** për sigurimin e padisë, duke pezulluar ekzekutimin e aktit administrativ të Departamentit të Administratës Publike, me nr.5446/3 prot., datë 05.02.2018, “Raporti Përfundimtar i Inspektimit të zhvilluar në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit të Provës”, në pjesën që i preket interesi paditësit.

Konkluzion: Në këto rrethana, bazuar në parimin e sanksionuar në nenin 36, të ligjit nr. 8116 datë 29.3.1996, “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, që institucionet e tjera nuk mund të trajtojnë çështje që po trajtohen apo janë trajtuar nga sistemi gjyqësor, Komisioneri vlerëson se kjo çështje do të marrë një zgjidhje përfundimtare nga gjykata, në përfundim të gjithë fazave të gjykimit.

➤ **Konstatim:**

Ndërkohë, në vijim të procesit të mbledhjes dhe këqyrjes së dokumentacionit, në datën 01.06.2018, grupi i punës ka shkuar në subjektin e mbikëqyrjes dhe ka konstatuar se për 6 punonjës, të evidentuar gjatë mbikëqyrjes si raste që nuk i përmbushnin kriteret për të qenë nëpunës civilë, në përputhje me kërkesat e nenit 67, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe Vendimit nr. 116, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, nga ana e njësisë së menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit, është reaguar, duke marrë masa për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës. Bëhet fjalë për punonjësit si më poshtë:

1. ***** në pozicionin e punës, “Drejtor i Zyrës Vendore të Shërbimit të Provës, Kavajë”, i cili nuk përmbushte kriterin e vjetërsisë në punë për këtë pozicion pune dhe

janë ndërprerë marrëdhëniet financiare me urdhrin nr. 2453, datë 30.05.2018, të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit të Provës.

2. *****, në pozicionin e punës, “*Drejtor i Zyrës Vendore të Shërbimit të Provës, Durrës*”, i cili nuk përmbushte kriterin e vjetërsisë në punë për këtë pozicion pune dhe janë ndërprerë marrëdhëniet financiare me urdhrin nr. 2421, datë 25.05.2018, të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit të Provës.
3. *****, në pozicionin e punës, “*Specialist në Drejtorinë e Mbikëqyrjes Elektronike*”, i cili nuk përmbushte kriterin e arsimit për këtë pozicion pune dhe janë ndërprerë marrëdhëniet financiare me urdhrin nr. 2464, datë 31.05.2018, të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit të Provës.
4. *****, në pozicionin e punës, “*Specialist në Drejtorinë e Mbikëqyrjes Elektronike*”, i cili nuk përmbushte kriterin e arsimit për këtë pozicion pune dhe janë ndërprerë marrëdhëniet financiare me urdhrin nr. 2463, datë 31.05.2018, të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit të Provës.
5. *****, në pozicionin e punës, “*Drejtor i Zyrës Vendore të Shërbimit të Provës, Berat*”, i cili nuk përmbush kriterin e vjetërsisë në punë për këtë pozicion pune dhe janë ndërprerë marrëdhëniet financiare me urdhrin nr. 2454, datë 30.05.2018, të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit të Provës.
6. *****, në pozicionin e punës, “*Specialist në Zyrën Vendore të Shërbimit të Provës, Krujë*”, i cili nuk përmbush kriterin e vjetërsisë në punë për këtë pozicion pune dhe janë ndërprerë marrëdhëniet financiare me urdhrin nr. 2462, datë 31.05.2018, të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit të Provës.

Për këtë arsye, këto raste nuk do të evidentohen në vendimin e paralajmërimit që do të nxjerrë Komisioneri për rregullimin e paligjshmërisë.

III. Procesi i deklarimit të statusit të punësimit në raport me afatet ligjore

Vendimi nr. 116, datë 05.03.2014, i Këshillit të Ministrave, “*Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, (ndryshuar me vendimin nr. 532, datë 06.08.2014 të Këshillit të Ministrave; ndryshuar me vendimin nr. 627, datë 24.09.2014, të Këshillit të Ministrave)*, ka parashikuar procedurat e hollësishme që duhet të kryejë njësia përgjegjëse për të realizuar deklarimin e statusit të punësimit për punonjësit dhe nëpunësit aktualë si dhe afatin brenda të cilit duhet të përfundojë i gjithë ky proces. Në Kreun IV, të vendimit si më sipër, është përcaktuar se: “*Procedura e deklarimit të statusit të punësimit përfundon jo më vonë se 120 (njëqind e njëzetë) ditë nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi. ... Në çdo rast, shtyrja e afatit nuk mund të jetë më vonë se data 30 tetor 2014 ...*”.

Në zbatim të programit dhe drejtimeve të mbikëqyrjes konstatohet se, Departamenti i Administratës Publike, si njësi përgjegjëse për institucionin e mbikëqyrur, i ka përfunduar procedurat e deklarimit të statusit të punësimit në datën **30 tetor 2014**, pra brenda afatit të vendosur në aktin nënligjor.

Të dhënat që pasqyrojnë realizimin e procedurës së deklarimit të statusit të punësimit, siç janë: akti për fillimin e marrëdhënieve të punës në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit të Provës;

akti i deklaramit të statusit të punësimit “Nëpunës civil” apo “Nëpunës civil në periudhë provës”, si dhe të dhënat lidhur me përmbushjen e detyrimeve të periudhës së provës, janë të pasqyruara në mënyrë analitike në anekset nr. 1 dhe nr. 2 dhe që i bashkëlidhen raportit si pjesë përbërëse e tij.

IV. Rastet e rekrutimeve, lëvizjeve paralele dhe ngritjes në detyrë, pas momentit të fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar

Gjatë procesit të mbikëqyrjes konstatohet se në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit të Provës u konstatuan **3 raste** të emërimit nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil, e parashikuar në nenin 22 dhe 23, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe në vendimin nr. 243, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”.

• **Pranimi në shërbimin civil në nivel ekzekutiv**

Në këtë rast, sipas procedurave të rekrutimit, pranim në shërbimin civil në nivelin ekzekutiv janë shpallur fitues punonjësit si më poshtë:

- ✓ *****, emëruar në pozicionin e punës, “Specialist, në Zyrën Vendore të Shërbimit të Provës, Tiranë”, me aktin e emërimit nr. 56, datë 07.01.2015, të Departamentit të Administratës Publike.
- ✓ *****, emëruar në pozicionin e punës, “Specialist, në Zyrën Vendore të Shërbimit të Provës, Dibër”, me aktin e emërimit nr. 57, datë 07.01.2015, të Departamentit të Administratës Publike.
- ✓ *****, emëruar në pozicionin e punës, “Specialist, në Zyrën Vendore të Shërbimit të Provës, Krujë”, me aktin e emërimit nr. 66, datë 07.01.2015, të Departamentit të Administratës Publike.

Konkluzion: Komisioneri vlerëson se, procedurat e rekrutimit, nëpërmjet konkurrimit të hapur pranim në shërbimin civil, janë kryer nga njësia përgjegjëse, Departamenti i Administratës Publike, sipas përcaktimeve në ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij.

➤ **Konstatim:**

Ndërkohë, nga ana tjetër, gjatë procesit të mbikëqyrjes konstatohet se, në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit të Provës, pas fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, janë rekrutuar punonjës në pozicione pune të shërbimit civil, me akte emërimi (kontratë të përkohshme), në kundërshtim me ligjin, të cilat do të evidentohen me hollësi në tabelat më poshtë.

Ky fakt është konstatuar edhe nga Departamenti i Administratës Publike në raportin përfundimtar të inspektimit të zhvilluar në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit të Provës,

duke rekomanduar në këto raste ndërprerjen e marrëdhënieve të punës, sipas parashikimeve të nenit 110, të Kodit të Procedurave Administrative.

Ndërkohë, në vijim të procesit të mbledhjes dhe këqyrjes së dokumentacionit, në datën 14.05.2018, grupi i punës ka shkuar në subjektin e mbikëqyrjes dhe ka konstatuar nëpërmjet një proces-verbali administrativ, se për 40 raste, të evidentuara më parë si raste të emërimeve në kundërshtim me ligjin, aktualisht janë marrë masa për ndërprerjen e marrëdhënies së punës dhe atyre financiare. Më tej, konstatohet në 5 raste është revokuar akti i lirimit dhe punonjësit janë rikthyer në detyrë me pretendimin e nevojave të punës. Bëhet fjalë për punonjësit e renditur më poshtë sipas gjeneraliteteve, pozicionit të punës dhe aktit të lirimit:

Tabelë nr. 1: Rastet e ndërprerjes së marrëdhënies së punës, për punonjës të emëruar në kundërshtim me ligjin për nëpunësin civil.

Nr.	Emri Mbiemri	Pozicioni i punës	Data e urdhrimit të lirimit	Data e urdhrimit të revokimit (rikthyer në detyrë për nevoja pune)
1	*****	Specialiste në Drejtorinë e Mbikëqyrjes Elektronike	Urdhër Nr. 2143, datë 30.04.2018	Urdhër nr. 2181, datë 02.05.2018
2	*****	Specialist në Drejtorinë e Mbikëqyrjes Elektronike	Urdhër Nr. 2120, datë 30.04.2018	Urdhër nr. 2120/1, datë 30.04.2018
3	*****	Specialist në Drejtorinë e Mbikëqyrjes Elektronike dhe Specialist në ZVSHP Tiranë	Urdhër Nr. 2122, datë 30.04.2018	
4	*****	Specialist në Drejtorinë e Mbikëqyrjes Elektronike	Urdhër Nr. 2119, datë 30.04.2018	Urdhër nr. 2119/1, datë 30.04.2018
5	*****	Specialiste në Drejtorinë e Mbikëqyrjes Elektronike	Urdhër Nr. 2121, datë 30.04.2018	Urdhër nr. 2182, datë 02.05.2018
6	*****	Specialiste në Zyrën Vendore Tiranë	Urdhër Nr. 2288, datë 11.05.2018	
7	*****	Specialiste në Zyrën Vendore Tiranë	Urdhër Nr. 2142, datë 30.04.2018	

8	*****	Specialiste në Zyrën Vendore Tiranë	Urdhër Nr. 2289, datë 11.05.2018	
9	*****	Specialist në Zyrën Vendore Tiranë	Urdhër Nr. 2287, datë 11.05.2018	
10	*****	Specialist në Zyrën Vendore Tiranë	Urdhër Nr. 2140, datë 30.04.2018	
11	*****	Specialist në Zyrën Vendore Tiranë	Urdhër nr. 2123, datë 30.04.2018	
12	*****	Specialist në Zyrën Vendore Tiranë	Urdhër nr. 2139, datë 30.04.2018	
13	*****	Specialist në Zyrën Vendore Tiranë	Urdhër nr. 2141, date 30.04.2018	
14	*****	Specialist në Zyrën Vendore Tiranë	Urdhër nr. 2138, date 30.04.2018	
15	*****	Specialist në Zyrën Vendore Kavajë	Urdhër nr. 2137, datë 30.04.2018	
16	*****	Specialist në Zyrën Vendore Lushnje	Urdhër nr. 2133, datë 30.04.2018	
17	*****	Specialist në Zyrën Vendore Lushnje	Urdhër nr. 2134, datë 30.04.2018	
18	*****	Specialist në Zyrën Vendore Lushnje	Urdhër nr. 2135, datë 30.04.2018	
19	*****	Specialist në Zyrën Vendore Lushnje	Urdhër nr. 2136, datë 30.04.2018	
20	*****	Specialist në Zyrën Vendore Lezhë	Urdhër Nr. 2290, datë 11.05.2018	
21	*****	Specialist në Zyrën Vendore Dibër	Urdhër nr. 2199, datë 04.05.2018	
22	*****	Specialist në Zyrën Vendore Fier	Urdhër nr. 2132, datë 30.04.2018	
23	*****	Specialist në Zyrën Vendore Fier	Urdhër nr. 2131, datë 30.04.2018	
24	*****	Specialist në Zyrën Vendore Fier	Urdhër nr. 2200, datë 04.05.2018	

25	*****	Specialist në Zyrën Vendore Kurbin	Urdhër nr. 2201, datë 04.05.2018	
26	*****	Specialist në Zyrën Vendore Elbasan	Urdhër nr. 2130, datë 30.04.2018	
27	*****	Specialist në Zyrën Vendore Elbasan	Urdhër nr. 2129, datë 30.04.2018	
28	*****	Specialist në Zyrën Vendore Vlore	Urdhër nr. 2128, datë 30.04.2018	
29	*****	Specialist në Zyrën Vendore Vlore	Urdhër nr. 2127, datë 30.04.2018	
30	*****	Specialist në Zyrën Vendore Vlore	Urdhër nr. 2126, datë 30.04.2018	
31	*****	Specialist në Zyrën Vendore Gjirokastrë	Urdhër nr. 2202, datë 04.05.2018	
32	*****	Specialist në Zyrën Vendore Mat	Urdhër nr. 2203, datë 04.05.2018	
33	*****	Specialist në Zyrën Vendore Kukës	Urdhër nr. 2292, datë 11.05.2018	
34	*****	Specialist në Zyrën Vendore Pogradec	Urdhër nr. 2204, datë 04.05.2018	
35	*****	Specialist në Zyrën Vendore Pogradec	Urdhër nr. 2125, date 30.04.2018	Urdhër nr. 2212, datë 04.05.2018
36	*****	Specialist në Zyrën Vendore Pukë	Urdhër nr. 2205, datë 04.05.2018	
37	*****	Specialist në Zyrën Vendore Tropojë	Urdhër nr. 2206, date 04.05.2018	
38	*****	Specialist në Zyrën Vendore Sarandë	Urdhër nr. 2291, datë 11.05.2018	
39	*****	Specialist në Zyrën Vendore Korçë	Urdhër nr. 2207, datë 04.05.2018	
40	*****	Specialist në Zyrën Vendore Fier	Urdhër nr. 2124, datë 30.04.2018	

Po kështu, në datën 01.06.2018, grupi i punës ka shkuar në subjektin e mbikëqyrjes dhe ka konstatuar nëpërmjet një proces-verbali administrativ, se për 14 raste, të tjera, të evidentuara më parë si raste të emërimeve në kundërshtim me ligjin, aktualisht janë marrë masa për ndërprerjen e marrëdhënies së punës dhe atyre financiare. Më tej, konstatohet në 3 raste është revokuar akti

i lirimit dhe punonjësit janë rikthyer në detyrë me pretendimin e nevojave të punës. Bëhet fjalë për punonjësit e renditur më poshtë sipas gjeneraliteteve, pozicionit të punës dhe aktit të lirimit:

Tabelë nr. 2: Rastet e ndërprerjes së marrëdhënies së punës, për punonjës të emëruar në kundërshtim me ligjin për nëpunësin civil.

Nr.	Emri Mbiemri	Pozicioni i punës	Data e urdhrimit të Lirimit	Data e urdhrimit të revokimit <i>(rikthyer në detyrë për nevoja pune)</i>
1	*****	Specialiste në Drejtorinë e Mbikëqyrjes Elektronike	Urdhër Nr. 2368, datë 18.05.2018	Urdhër nr. 2372, datë 18.05.2018
2	*****	Specialiste në Zyrën Vendore Krujë	Urdhër Nr. 2462, datë 31.05.2018	
3	*****	Specialist në Drejtorinë e Mbikëqyrjes Elektronike	Urdhër Nr. 2464, datë 31.05.2018	
4	*****		Urdhër Nr. 2453, datë 30.05.2018	
5	*****	Specialiste në Drejtorinë e Mbikëqyrjes Elektronike	Urdhër Nr. 2463, datë 31.05.2018	
6	*****	Drejtor i Zyrës Vendore Berat	Urdhër Nr. 2454, datë 30.05.2018	
7	*****	Specialiste në Zyrën Vendore Sarandë	Urdhër Nr. 2370, datë 18.05.2018	
8	*****	Inspektore ne Drejtorinë e Inspektimit dhe Shërbimeve Komunitare	Urdhër Nr. 2458, datë 31.05.2018	
9	*****	Specialist në Zyrën Vendore Berat	Urdhër Nr. 2367, datë 18.05.2018	

10	*****	Specialist në Zyrën Vendore Kurbini	Urdhër Nr. 2420, datë 18.05.2018	
11	*****	Drejtor i Zyrës Vendore Durrës	Urdhër nr. 2421 datë 25.05.2018	
12	*****	Specialist në Zyrën Vendore Përmet	Urdhër nr. 2369 datë 18.05.2018	
13	*****	Specialist në Zyrën Vendore Korçë	Urdhër nr. 2207, datë 04.05.2018	Urdhër nr. 2349, datë 15.05.2018
14	*****	Specialist në Zyrën Vendore Lushnje	Urdhër nr. 2134, datë 30.04.2018	Urdhër nr. 2348, datë 15.05.2018

Në këto rrethana, në këtë institucion deri në momentin e dërgimit të projekt raportit të mbikëqyrjes, në datën 06.07.2018, ende vijonin marrëdhënien e punës 10 punonjës, të punësuar duke mos respektuar procedurat e parashikuara në ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, i cili parashikon se rekrutimi në shërbimin civil kryhet vetëm nëpërmjet procedurave të konkurrimit, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit.

Ndërkohë, sipas observacioneve të institucionit dhe akteve bashkëlidhur, që janë urdhrat e përfundimit të marrëdhënies së punës, konstatohet se për **9** raste të punonjësve të marrë në punë, duke mos respektuar procedurat e parashikuara në ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, është reaguar duke rregulluar në këtë mënyrë paligjshmërinë e evidentuar në projekt raport. Për këtë arsye, ky aspekt nuk do të përfshihet në vendimin e paralajmërimit që do të nxjerrë Komisioneri për rivendosjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil.

Konkluzion: Komisioneri vlerëson se, nga ana e institucionit është rregulluar situata e paligjshmërisë, sepse nga ana e titullarit të institucionit është konstatuar pavlefshmëria absolute e akteve të emërimit në përputhje me nenin 110, të Kodit të Procedurave Administrative dhe janë rregulluar pasojat duke vendosur menjëherë përfundimin e marrëdhënies së punës, për punonjësit si më poshtë:

- ✓ *****, në pozicionin e punës, “*Specialist, në Zyrën Vendore të Shërbimit të Provës, Pogradec*”, janë ndërprerë marrëdhëniet financiare me urdhrin nr. 2900, datë 17.07.2018, të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit të Provës.
- ✓ *****, në pozicionin e punës, “*Specialist, në Zyrën Vendore të Shërbimit të Provës, Lushnje*”, janë ndërprerë marrëdhëniet financiare me urdhrin nr. 2902, datë 17.07.2018, të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit të Provës.
- ✓ *****, në pozicionin e punës, “*Specialist, në Zyrën Vendore të Shërbimit të Provës, Korçë*”, janë ndërprerë marrëdhëniet financiare me urdhrin nr. 2709, datë 02.07.2018, të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit të Provës.
- ✓ *****, në pozicionin e punës, “*Specialist, në Drejtorinë e Mbikëqyrjes Elektronike, Tiranë*”, janë ndërprerë marrëdhëniet financiare me urdhrin nr. 2835, datë 11.07.2018, të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit të Provës.

- ✓ *****, në pozicionin e punës, në pozicionin e punës, “*Specialist, në Drejtorinë e Mbikëqyrjes Elektronike, Tiranë*”, janë ndërprerë marrëdhëniet financiare me urdhrin nr. 2839, datë 11.07.2018, të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit të Provës.
- ✓ *****, në pozicionin e punës, “*Specialist, në Drejtorinë e Mbikëqyrjes Elektronike, Tiranë*”, janë ndërprerë marrëdhëniet financiare me urdhrin nr. 2837, datë 11.07.2018, të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit të Provës.
- ✓ *****, në pozicionin e punës, “*Specialist, në Drejtorinë e Mbikëqyrjes Elektronike, Tiranë*”, janë ndërprerë marrëdhëniet financiare me urdhrin nr. 2838, datë 11.07.2018, të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit të Provës.
- ✓ *****, në pozicionin e punës, “*Specialist, në Drejtorinë e Mbikëqyrjes Elektronike, Tiranë*”, janë ndërprerë marrëdhëniet financiare me urdhrin nr. 2836, datë 11.07.2018, të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit të Provës.
- ✓ *****, në pozicionin e punës, “*Drejtor, Zyrën Vendore të Shërbimit të Provës, Tropojë*”, janë ndërprerë marrëdhëniet financiare me urdhrin nr. 2958, datë 25.07.2018, të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit të Provës.

➤ Lidhur me rastin e punonjësës *****, në pozicionin e punës, “*Specialist, në Zyrën Vendore të Shërbimit të Provës, Tiranë*”, emëruar sipas urdhrin nr. 1173, datë 25.05.2017, të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit të Provës, konstatohet se ajo vijon ende në këtë detyrë.

Nëpërmjet shkresës nr. 2997/2 prot., datë 27.07.2018, institucioni i mbikëqyrur ka dërguar njoftimet me nr. 2912 prot., datë 18.07.2018 dhe nr. 2983 prot., datë 27.07.2018, për zhvillimin e procedurës për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës midis Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Provës dhe Suela Fetahu, proces i cili ende nuk ka përfunduar.

Konkluzion: Për sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, për të rregulluar situatën e paligjshmërisë në rastin e emërimit në kundërshtim me ligjin, nga ana e institucionit, duhet të kryhen veprimet si më poshtë:

- ✓ Nga ana e titullarit të institucionit të konstatohet menjëherë pavlefshmëria absolute e aktit të emërimit nr. 1173, datë 25.05.2017, të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit të Provës për punonjësën *****, në pozicionin e punës, “*Specialist, në Zyrën Vendore të Shërbimit të provës, Tiranë*”, në përputhje me nenin 110 të Kodit të Procedurave Administrative dhe të rregullohen pasojat duke vendosur menjëherë përfundimin e marrëdhënies së punës. Ky pozicion, të shpallet i lirë dhe të plotësohet nëpërmjet konkurrimit. Në mbështetje të këtij konkluzioni vijnë edhe parashikimet e nenit 23, pika 4, të ligjit për nëpunësin civil, të cilat e konsiderojnë aktin e emërimit në këtë rast si absolutisht të pavlefshëm, i cili nuk mund të prodhojë pasoja ligjore.

V. **Respektimi i kërkesave specifike ligjore, gjatë procesit të përmbushjes së periudhës së provës**

Nëpunësit civil që emërohen për herë të parë në shërbimin civil i nënshtrohen një periudhe prove. Afati i periudhës së provës si dhe detyrat që duhet të përmbushë nëpunësi dhe institucioni përgjatë kësaj periudhe dhe në përfundim të saj, janë të përcaktuara në nenin 24, të ligjit

nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; Kreun V, të vendimit nr. 143, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për procedurat e rekrutimit, të përzgjedhjes, të periudhës së provës, lëvizjes paralele e të ngritjes në detyrë për nëpunësit civil të kategorisë ekzekutive, të ulët dhe të mesme drejtuese”, (për të gjitha ato procedura që kanë filluar gjatë kohës që ka qenë në fuqi kjo VKM); si dhe në Kreun VI, të vendimit nr. 243, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”.

Ndërsa për nëpunësit dhe punonjësit ekzistues, (nëpunësit dhe punonjësit që fillimi i efekteve të ligjit i gjeti në funksione të shërbimit civil) dhe që kishin një periudhë punësimit më të vogël se një vit, në pikën 4, të nenit 67, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, është përcaktuar se për ta zbatohet neni 24, i këtij ligji dhe se periudha e provës fillon nga fillimi i efekteve juridike të ligjit.

Në mbështetje të këtyre dispozitave ligjore, nëpunësi në periudhë prove është i detyruar të ndjekë programin e detyrueshëm të trajnimit për periudhën e provës pranë ASPA-s dhe udhëzimet e nëpunësit më të vjetër civil, nën kujdesin e të cilit ai është vendosur.

Eprori direkt i nëpunësit në periudhë prove, duhet të caktojë nëpunësin më të vjetër nën kujdesin e të cilit do të vendoset nëpunësi civil në periudhë prove, të bëjë vlerësimin e rezultateve individuale në punë për periudhën e provës dhe të nxjerrë vendimin për përfundimin e periudhës së provës.

Në zbatim të planit të mbikëqyrjes, u verifikua tërësia e veprimeve të kryera për konfirmimin e nëpunësve civilë, të cilët i janë nënshtruar periudhës së provës dhe që aktualisht vazhdojnë marrëdhëniet e punësimit me institucionin.

Nga verifikimi i dokumentacionit që u vu në dispozicion lidhur me këtë aspekt të administrimit të shërbimit civil, rezulton se:

- Gjatë periudhës së provës, nëpunësit kanë kryer ciklin e detyrueshëm të trajnimit pranë Shkollës së Administratës Publike (ASPA) dhe në fund të trajnimit i janë nënshtruar testimit. Bazuar në pikën 2, të Kreut IV, të vendimit nr. 138, datë 13.02.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për rregullat e organizimit e të funksionimit të shkollës shqiptare të administratës publike dhe trajnimit e nëpunësve civil”, i ndryshuar, trajnimi për periudhën e provës pranë ASPA-s konsiderohet i ndjekur me sukses nëse nëpunësi merr të paktën 50 % të pikëve në testim.
- Nëpunësve iu është bërë vlerësimi i rezultateve individuale në punë, për periudhën e provës, sipas procedurave të përcaktuara në aktin nënligjor për vlerësimin e arritjeve vjetore.
- Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës, me shkresën nr. 2101 prot., datë 27.04.2018, i ka përcjellë Departamentit të Administratës Publike, listën e nëpunësve civilë në periudhë prove, të cilët kanë përmbushur kriteret ligjore në fuqi mbi shërbimin civil, (37 nëpunës civilë në periudhë prove, sipas deklaramentit të vitit 2014 dhe 3 rekrutimet e vitit 2015) konkretisht si më poshtë:

1. *****/ Urdhër Nr. 57, datë 07.01.2015
2. *****/ Urdhër Nr. 353, datë 25.02.2014

3. *****/Urdhër Nr. 1838, datë 12.11.2013
4. *****/Urdhër Nr. 2151, datë 31.12.2013
5. *****/Urdhër Nr. 370, datë 25.02.2014
6. *****/Urdhër Nr. 92, datë 23.01.2014
7. *****/Urdhër Nr. 2055, datë 20.02.2013
8. *****/Urdhër Nr. 66, datë 07.01.2015
9. *****/Urdhër Nr. 240, datë 10.02.2014
10. *****/Urdhër Nr. 2057, datë 20.12.2013
11. *****/Urdhër Nr. 143, datë 30.01.2014
12. *****/Urdhër Nr. 193, datë 04.02.2014
13. *****/Urdhër Nr. 368, datë 25.02.2014
14. *****/Urdhër Nr. 370, datë 25.02.2014
15. *****/Urdhër Nr. 373, datë 23.02.2014
16. *****/Urdhër Nr. 335, datë 25.02.2014
17. *****/Urdhër Nr. 2056, datë 20.12.2013
18. *****/Urdhër Nr. 365, datë 25.02.2014
19. *****/Urdhër Nr. 1970, datë 06.12.2013
20. *****/Urdhër Nr. 371, datë 25.02.2014
21. *****/Nr.56, datë 07.01.2015
22. *****/Urdhër Nr. 367, datë 25.02.2014
23. *****/Urdhër Nr. 2105, datë 27.12.2013
24. *****/Urdhër Nr. 2037, datë 18.12.2013
25. *****/Urdhër Nr. 2058, datë 20.12.2013
26. *****/Urdhër Nr. 363, datë 25.02.2014
27. *****/Urdhër Nr. 1144, datë 04.09.2013
28. *****/Urdhër Nr. 1969, datë 06.12.2013
29. *****/Urdhër Nr. 1210, datë 30.07.2013
30. *****/Urdhër Nr. 1143/1 , datë 04.09.2013
31. *****/Urdhër Nr. 1879, datë 22.11.2013
32. *****/Urdhër Nr. 2150, datë 31.12.2013
33. *****/Urdhër Nr. 2104, datë 27.12.2013
34. *****/Urdhër Nr. 1878, datë 22.11.2013
35. *****/Urdhër Nr. 1176, datë 18.07.2013
36. *****/Urdhër Nr. 1032, datë 18.07.2013
37. *****/Urdhër Nr. 2158, datë 31.12.2013
38. *****/Urdhër Nr. 352, datë 25.02.2014
39. *****/Urdhër Nr. 1111, datë 04.07.2013
40. *****/Urdhër Nr. 359/2, datë 25.02.2014

Në 37 nga këto raste, punonjësit në momentin e fillimit së efekteve juridike të ligjit (data 26.02.2014) e kishin periudhën e punësimit në të njëjtin vend, më pak se një vit dhe për këtë

arsye përfituan sipas nenit 67, pika 4, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore që kanë dalë në bazë dhe për zbatim të tij, statusin e punësimit “nëpunës civil në periudhë prove”.

Ndërkohë, për 3 raste (*****, ***** dhe *****), nga njësia përgjegjëse (DAP) gjatë vitit 2015, është zbatuar procedura e pranimit në shërbimin civil, e parashikuar në nenin 22 dhe 23, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar si dhe në vendimin nr. 243, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”.

Në lidhje me këtë moment të konstatuar si parregullsi në projekt raport, institucioni i mbikëqyrur ka dërguar vendimet e konfirmimit pas përfundimit të periudhës së provës, për të gjithë nëpunësit civilë, për të cilët kishte përfunduar afati 1 vjeçar. Për këtë arsye, ky aspekt nuk do të pasqyrohet në vendimin paralajmërues të Komisionerit.

Konkluzion: Për sa u analizua më sipër, Komisioneri vlerëson se është finalizuar procesi i konfirmimit të punonjësve në përputhje me kërkesat e nenit 24, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, ashtu si është analizuar edhe në rubrikën ku bëhet fjalë për kategorinë e nëpunësve në periudhë prove për shkak të ligjit.

VI. Respektimi i kërkesave ligjore në hartimin e formularit të përshkrimit të punës sipas formatit të përcaktuar nga ligji nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar dhe aktet nënligjore në zbatim të tij

Në zbatim të programit dhe drejtimeve të mbikëqyrjes, për të gjitha pozicionet e punës pjesë e shërbimit civil, u verifikuan përshkrimet e punës, për të vlerësuar nëse janë respektuar rregullat e përcaktuara në vendimin nr. 142, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, i ndryshuar, si dhe udhëzimin nr. 2, datë 07.04.2014, të Departamentit të Administratës Publike, “Për hartimin e përshkrimit të pozicioneve të punës në shërbimin civil”, akte që kanë dalë në bazë dhe për zbatim të nenit 19, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Këto akte nënligjore, në përmbajtjen e tyre kanë të përcaktuara rastet kur një institucion, pjesë e shërbimit civil, duhet të hartojë përshkrimet e punës, procedurat e hollësishme që duhet të ndiqen si dhe nëpunësit përgjegjës në këtë proces.

Më konkretisht, vendimi nr. 142, datë 12.03.2014, i Këshillit të Ministrave, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, i ndryshuar, në Kreun IV, “Procedura dhe formati i përshkrimit të punës” (pika 14), përcakton se:

“Përshkrimet e punës hartohen kur krijohen institucione të reja, kur ndryshon mënyra e organizimit të institucionit apo kur kanë ndodhur ndryshime ose miratime të legjislationit specifik mbi bazën e të cilit funksionon institucioni”.

Përshkrimi i punës hartohet nga analisti i punës, në bashkëpunim me eprorin direkt të pozicionit respektiv të punës dhe në rastet kur analisti i punës mungon në strukturën e institucionit, për të cilin ka lindur nevoja e hartimit të përshkrimeve të punës, ky proces realizohet nga drejtuesi i njësisë organizative për menaxhimin e burimeve njerëzore, në bashkëpunim me eprorin direkt të pozicionit respektiv të punës.

Vendimi nr. 142, datë 12.03.2014 i Këshillit të Ministrave, *“Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”*, në kreun VI, *“Dispozita transitorë”*, pika 40, ka parashikuar që, të gjitha institucionet pjesë e shërbimit civil, të përfundojnë hartimin e përshkrimit të punës, deri në datën 1 korrik 2014, afat i cili në këtë rast nuk është respektuar.

Nga verifikimi rezultoi se, janë konstatuar përpjekje për të hartuar përshkrimet e punës në përputhje me formatin standard të miratuar, për pozicionet e punës që janë pjesë e shërbimit civil. Këto akte ende nuk janë finalizuar, por aktualisht janë në fazën kur janë nënshkruar nga eprori direkt dhe nga nëpunësi civil që punon në pozicionin për të cilin është hartuar përshkrimi i punës, *por nuk janë miratuar nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Drejtësisë*, detyrim i cili rrjedh nga zbatimi i pikës 4.2.10, të udhëzimit nr. 2, datë 07.04.2014 të Departamentit të Administratës Publike, *“Për hartimin e përshkrimit të pozicioneve të punës në shërbimin civil”*, çka provohet me faktin se në akt mungon nënshkrimi i tij.

Në këto rrethana, procesi i miratimit të përshkrimeve të punës ende nuk ka përfunduar në të gjitha fazat e tij, pasi nuk ka marrë miratimin e Sekretarit të Përgjithshëm të institucionit dhe të Departamentit të Administratës Publike, në rolin e njësisë Përgjegjëse.

Sipas pikës 19, të vendimit nr. 142, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave, *“Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”*, Departamenti i Administratës Publike në cilësinë e njësisë përgjegjëse për institucionet e administratës shtetërore, kthen për rishikim përshkrimet e punës për pozicionet respektive, në rast se vëren se ato, nuk janë hartuar në bazë dhe në përputhje me legjislacionin specifik të fushës apo formatin standard të miratuar.

Mbështetur në sa parashikohet në këtë pikë, theksojmë se, e drejta e Departamentit të Administratës Publike, për të rikthyer për rishikim përshkrimet e punës, nënkupton edhe detyrimin e këtij organi për të aprovuar në mënyrë shkresore rregullshmërinë e përshkrimeve të punës, duke e bërë me dije zyrtarisht institucionin e mbikëqyrur dhe Sekretarin e Përgjithshëm të ministrisë së linjës, se përshkrimet e punës janë në bazë dhe në përputhje me legjislacionin specifik të fushës, me qëllim që ata të vijnë me procedurën e depozitimit të tyre pranë Departamentit të Administratës Publike.

Gjatë procesit të mbikëqyrjes, në këtë rast u konstatua se, procedura e bashkëpunimit ndërmjet strukturave/nëpunësve përgjegjës për realizimin e këtij procesi, që janë analist pune/ epror direkt i pozicionit përkatës/Departamenti i Administratës Publike, janë realizuar vetëm në formë elektronike.

Nga përmbajtja e aktit të përshkrimit të punës, në këtë fazë të formatimit të tij, në lidhje me rubrikat që janë materializuar në të, konstatohet se janë përfshirë elementet, sipas modelit

standard të hartuar nga Departamenti i Administratës Publike, si dhe të dhënat për pozicionin e punës, misioni, qëllimi i përgjithshëm i pozicionit të punës, detyrat kryesore, përgjegjësitë kryesore, zgjidhja e problemeve, vendimmarrja, mjedisi menaxherial, mbikëqyrja, stafi në varësi, kushtet e punës dhe kërkesat e posaçme.

Në ndarjen “*Kërkesa të posaçme*”, janë përcaktuar kërkesat specifike të vendit të punës në lidhje me nivelin e edukimit dhe fushën kryesore të studimeve; përvojën në punë e përcaktuar në terma kohorë dhe pozicion përkatës; si dhe njohuritë e përgjithshme dhe specifike që nevojiten për përmbushjen e funksionit të pozicionit të punës.

Nga të dhënat e administruara, të cilat pasqyrohen në **aneksin nr. 2** “*Respektimi i kërkesave të përgjithshme, sipas nenit 21 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, për punonjësit që janë të emëruar në pozicione pune pjesë e shërbimit civil, deri në datën 26.02.2014, si dhe të punonjësve që janë aktualisht në pozicione pune pjesë e shërbimit civil*”, bashkëlidhur raportit, rezulton se nëpunësit e emëruar në përputhje me ligjin, i plotësojnë këto kërkesa.

Ajo ç’ka vlen të theksohet edhe njëherë në këtë rubrikë, është nevoja për të sjellë në koherencë me ligjin për nëpunësin civil, dispozitat ligjore mbi të cilat organizohen burimet njerëzore, në ligjin aktual që rregullon funksionimin e subjektit në fjalë, si edhe të akteve të tjera rregullative, pasi përshkrimet e punës janë ndërtuar mbi bazën e ligjit, akteve nënligjore, rregullores së brendshme të institucionit dhe strukturës organizative, akte të cilat janë miratuar të gjitha para fillimit të efekteve juridike të ligjit për nëpunësin civil, i cili e përfshiu këtë subjekt në shërbimin civil.

Konkretisht, në kushtet kur Rregullorja e Brendshme e veprimtarisë së Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Provës, është miratuar në vitin 2009 dhe për pasojë, në të nuk janë pasqyruar ndryshimet ligjore, si në drejtim të organizimit të brendshëm të institucionit me ligjin aktual, ashtu edhe në drejtim të përshtatjes së administrimit të burimeve njerëzore në koherencë me ligjin për shërbimin civil, me qëllim që të qartësohet roli dhe funksioni i çdo nëpunësi civil, lind nevoja e menjëhershme e hartimit të një Rregulloreje të Brendshme të re, për veprimtarinë e institucionit.

Konkluzion:

- ✓ Procesi i hartimit dhe miratimit të përshkrimeve të punës është një proces i një rëndësie të veçantë, i cili kryhet sipas një procedure administrative, që realizohet në disa faza, duke respektuar rregullat specifike dhe të afatet kohore, të përcaktuara në një akt nënligjor specifik, si dhe në udhëzimin e Departamentit të Administratës Publike, të analizuara më sipër.
- ✓ Në zbatim të këtyre akteve, struktura që administron burimet njerëzore në këtë subjekt, të kërkojë nga njësia përgjegjëse, (DAP), që të japë mendimin me shkrim, lidhur me përshkrimet e punës, nëse janë të hartuara në përputhje me legjislacionin specifik të fushës apo formatin standard të miratuar.
- ✓ Pas marrjes së konfirmimit nga njësia përgjegjëse, përshkrimet e punës t’i përcillen për miratim Sekretarit të Përgjithshëm të ministrisë së linjës, i cili e finalizon këtë proces,

duke nënshkruar përshkrimet e punës në ndarjen përkatëse, pasi nënshkrimi i formularit të përshkrimit të punës nga ana e tij, nga eprori direkt dhe nëpunësi civil për të cilin është hartuar përshkrimi i punës, është një detyrim specifik, i parashikuar në pikën 18, 19 dhe 20, të vendimit nr. 142, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”.

- ✓ Në përfundim të procedurave si më sipër, një kopje e përshkrimeve të punës të nënshkuara, të bëhen pjesë e dosjes së personelit të çdo nëpunësi civil dhe një kopje të depozitohet pranë Departamentit të Administratës Publike, ashtu si e parashikon ligji dhe aktet nënligjore që rregullojnë këtë aspekt.

VII. Procedura e ndjekur nga institucioni në lidhje me miratimin e planit vjetor të pranimi në shërbimin civil

Në zbatim të programit të mbikëqyrjes, në të cilin është përcaktuar se, mbikëqyrja përfshin ligjshmërinë në administrimin e shërbimit civil, për periudhën kohore nga momenti i fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, e në vijim, grupi i punës verifikoi planifikimin e nevojave për rekrutim në shërbimin civil për vitin 2017.

Konstatohet se, planifikimi i nevojave për rekrutim në shërbimin civil, në institucionin e mbikëqyrtur, është realizuar duke u bazuar në përcaktimet e nenit 18, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe vendimit nr. 108, datë 26.02.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për planin vjetor të pranimi në shërbimin civil”.

Mbështetur në këto dispozita, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore ka përgatitur planin e nevojave për rekrutim për vitin 2017 dhe 2018, të cilin ja ka bërë të njohur Departamentit të Administratës Publike dhe për dijeni sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Drejtësisë.

Konkretisht me shkresën me nr. 2814 prot., datë 27.12.2016, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës ka planifikuar nevojat për pranim për vitin 2017 dhe me shkresën nr. 1871 prot., datë 04.04.2018, ka përcaktuar vendet e lira për vitin 2018.

Ndërkohë, konstatohet se DAP, ka filluar procedurat e rekrutimit në lidhje me plotësimin e pozicioneve të lira në kuptim të ligjit, në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit të Provës, duke i shpallur për konkurrim këto pozicione. Gjatë procesit të mbikëqyrjes këto procedura janë ende në proces.

VII. Përfundimi i marrëdhënies në shërbimin civil për shkak të lirimit nga shërbimi civil: si rezultat i dorëheqjes ose për shkak të ligjit

Nga verifikimi i dokumentacionit që lidhet me institutin e lirimit nga shërbimi civil, u konstatua se për periudhën objekt mbikëqyrje nga viti 2017, deri në momentin e mbikëqyrjes, në institucionin e kontrolluar, evidentohen raste të dorëheqjes së paraqitur prej nëpunësve civilë, të cilat sqarohen hollësisht, më poshtë:

- Në **9 raste**, punonjësit janë liruar mbi bazën e kërkesës për dorëheqje të paraqitur prej tyre, sipas rregullit të përcaktuar në shkronjën “dh”, të pikës 1, të nenit 66, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar. Bëhet fjalë për punonjësit:
1. *****, në pozicionin e punës, “Specialiste, në Zyrën Vendore të Shërbimit të Provës, Tiranë”, është liruar me urdhrin nr. 294, datë 09.02.2017, mbi bazën e kërkesës për dorëheqje të paraqitur prej saj.
 2. *****, në pozicionin e punës, “Specialist, në Zyrën Vendore të Shërbimit të Provës, Tiranë”, është liruar me urdhrin nr. 424/1, datë 28.02.2017, mbi bazën e kërkesës për dorëheqje të paraqitur prej tij.
 3. *****, në pozicionin e punës, “Specialist, në Zyrën Vendore të Shërbimit të Provës, Durrës”, është liruar me urdhrin nr. 552/1, datë 13.03.2017, mbi bazën e kërkesës për dorëheqje të paraqitur prej tij.
 4. *****, në pozicionin e punës, “Specialist, në Zyrën Vendore të Shërbimit të Provës, Elbasan”, është liruar me urdhrin nr. 735/1, datë 31.03.2017, mbi bazën e kërkesës për dorëheqje të paraqitur prej saj.
 5. *****, në pozicionin e punës, “Specialiste, në Zyrën Vendore të Shërbimit të Provës, Tiranë”, është liruar me urdhrin nr. 975, datë 28.04.2017, mbi bazën e kërkesës për dorëheqje të paraqitur prej saj.
 6. *****, në pozicionin e punës, “Specialist, në Zyrën Vendore të Shërbimit të Provës, Fier”, është liruar me urdhrin nr. 982/1, datë 28.04.2017, mbi bazën e kërkesës për dorëheqje të paraqitur prej tij.
 7. *****, në pozicionin e punës, “Specialist, në Zyrën Vendore të Shërbimit të Provës, Durrës”, është liruar me urdhrin nr. 2151/1, datë 09.10.2017, mbi bazën e kërkesës për dorëheqje të paraqitur prej saj.
 8. *****, në pozicionin e punës, “Specialist, në Zyrën Vendore të Shërbimit të Provës, Fier”, është liruar me urdhrin nr. 1963/1, datë 12.04.2018, mbi bazën e kërkesës për dorëheqje të paraqitur prej tij.
 9. *****, në pozicionin e punës, “Inspektor, në Drejtorinë e Inspektimit dhe Shërbimeve Komunitare”, është liruar me urdhrin nr. 1044, datë 05.03.2018, mbi bazën e kërkesës për dorëheqje të paraqitur prej tij.

Konkluzion: Për sa analizuam me sipër, Komisioneri vlerëson se, njësia përgjegjëse ka vepruar drejt në lidhje me përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil për shkak të lirimit nga shërbimi civil, si rezultat i dorëheqjes apo plotësimit të moshës së pensionit të plotë të pleqërisë, në bazë të nenit 66, pika 1, germa ”dh”, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar. Nëpunësit në rastin e dorëheqjes, gëzojnë të drejtën që të konkurrojnë në procedurat e lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë për një periudhë 2 vjeçare, pas miratimit të kërkesës për dorëheqje.

VIII. Masat disiplinore dhe respektimi i procedurës ligjore

Instituti i disiplinës në shërbimin civil rregullohet në mënyrë të hollësishme në Kreun X, “Disiplina në shërbimin civil”, nga nenet 57 deri 61, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar. Në këtë kapitull përcaktohen në mënyrë specifike përgjegjësia për masat

disiplinore, llojet e masave disiplinore; kompetencat dhe procedura për masat disiplinore; parimet për përshkallëzimin dhe individualizimin e masës disiplinore dhe shuarja e masës disiplinore.

Në zbatim të këtyre dispozitave, në vendimin nr. 115, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në shërbimin civil” si dhe në udhëzimin nr. 1, datë 02.04.2014, të Departamentit të Administratës Publike, “Për elementët kryesore procedurale dhe materiale të ecurisë dhe shqyrtimit të shkeljeve disiplinore”, janë përcaktuar procedurat e hollësishme dhe të gjitha masat që duhet të ndërmerren nga personat kompetentë për dhënien dhe zbatimin e tyre.

Ligji i posaçëm dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij, në rastin e konstatimit të shkeljeve disiplinore përcaktojnë procedura të hollësishme, të cilat duhet të ndiqen nga personat kompetentë të ngarkuar nga ligji për fillimin e ecurisë disiplinore. Shkeljet disiplinore shumë të rënda janë përcaktuar në pikën 2, të nenit 57, të ligjit dhe në këtë rast, masa disiplinore që zbatohet ndaj nëpunësit civil, është “*largim nga shërbimi civil*”, i parashikuar në shkronjën “ç” të nenit 58, të ligjit në fjalë.

Në kuadër të drejtimeve të mbikëqyrjes, pas verifikimit të dokumentacioni të vënë në dispozicion në lidhje me praktikat e masave disiplinore, që janë aplikuar në administratën e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Provës, konstatohet se për periudhën objekt mbikëqyrje ka pasur disa procedura për dhënie mase disiplinore për vitin 2017, të cilat në mënyrë të përmbledhur janë pasqyruar sipas tabelës së mëposhtme.

Tabelë nr. 3 *Të dhëna në lidhje me institutin e disiplinës në shërbimin civil*

Emër mbiemer	Nr. Vendimi	Pozicioni i Punës	Data e marrjes së masës	Lloji i shkeljes	Lloji i masës
*****	Nr. 1	Drejtor (Komanduar) Elbasan	24.01.2017	Shkelje e lehte	Shpalljen e mungesës së kompetencës për këtë çështje disiplinore dhe ja delegon organit kompetent , Drejtorit të Zyrës Vendore për shqyrtimin e çështjes.
*****	Nr. 2	Drejtor ZVSHP Durrës	24.01.2017	Shkelje e lehte	Shpalljen e mungesës së kompetencës për këtë çështje disiplinore dhe ja delegon organit kompetent , Drejtorit të Zyrës Vendore për shqyrtimin e çështjes.
*****	Nr. 3	Drejtor (Komanduar) Kruje	24.01.2017	Shkelje e lehte	Shpalljen e mungesës së kompetencës për këtë çështje disiplinore dhe ja delegon organit kompetent , Drejtorit të Zyrës Vendore për shqyrtimin e çështjes.

*****	Nr. 4	Specialist Tirane	24.01.2017	Shkelja e rëndë	Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë , përfshirë rritjen në shkallë page për një periudhë deri në dy vjet.
*****	Nr. 5	Specialist Tirane	24.01.2017		Ndërprerje e ecurisë disiplinore
*****	Nr. 6	Specialist Tirane	10.02.2017		Ndërprerje e ecurisë disiplinore
*****	Nr. 7	Specialist M.E	29.03.2017	Shkelje e lehte	Shpalljen e mungesës së kompetencë për këtë çështje disiplinore dhe ja delegon organit kompetent , Drejtorit të Zyrës Vendore për shqyrtimin e çështjes.
*****	Shkresë Nr. 1747/1 prot, date 11.08.2017	Specialist M.E	11.08.2017	Vërejtje	Vërejtje nga Eprori Direkt
*****	Shkresë Nr. 1748/1 prot, date 11.08.2017	Specialist M.E	11.08.2017	Vërejtje	Vërejtje nga Eprori Direkt
*****	Nr.8	Specialist Korçë	14.08.2017	Shkelje e rëndë	Largim nga shërbimi civil

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, lidhur me zbatimin e masave disiplinore ndaj nëpunësve civilë, për vitin 2018, u konstatua se deri në momentin e realizimit të kësaj mbikëqyrje, masa disiplinore “*largimi nga shërbimi civil*”, i parashikuar si ndëshkimi administrativ më i rëndë për një nëpunës civil, është zbatuar në 1 rast.

Konkretisht, bëhet fjalë për nëpunësen *****, e cila ka filluar punë në datën 18.12.2013, në pozicionin e punës, “*Specialist Buxheti, në Drejtorinë e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse*”, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Provës. Me vendimin nr. 1, datë 2.02.2018, të Komisionit Disiplinor, rezulton se është marrë masa disiplinore “*largim nga shërbimi civil*”, për shkak të mospërbushjes së detyrave dhe mosrespektim të afateve të caktuara në përmbushje të detyrave në punë, konkretisht lidhur me braktisjen e punës dhe mungesa të pajustificuara në punë.

Gjatë shqyrtimit të këtij procedimi administrativ disiplinor, konstatohet se të gjitha vendimmarrjet e Komisionit Disiplinor janë realizuar në mbështetje të përcaktimeve të nenit 59, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar dhe Kreut II të vendimit nr. 115, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave “*Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil*”. Konkretisht, gjatë procedimit administrativ disiplinor është garantuar e drejta e nëpunësit për t’u njoftuar lidhur me fillimin e procedimit (*njoftimi nr. 160 prot., datë 25.01.2018*) dhe nga ana e Komisionit Disiplinor është mbajtur proces-verbal, në përmbajtjen e të cilit, janë evidentuar të gjitha faktet dhe janë vlerësuar rrethanat e ngjarjes që kanë qenë të nevojshme për marrjen e vendimit në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative (*proces-verbal nr. 1, datë 12.02.2018*).

Nëpunësja civile ***** nuk e ka ankimuar aktin e largimit nga shërbimi civil në Gjykatën Administrative, si organi kompetent për të shqyrtuar këtë çështje.

Konkluzion: Në këto rrethana, Komisioneri vlerëson se në të gjitha rastet e analizuara më sipër, Komisioni Disiplinor ka vepruar drejt duke respektuar dispozitat dhe procedurën e parashikuar në Kreun X, “Disiplina në shërbimin civil” që përfshin nenet 57, deri 61, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; Vendimit nr. 115, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në shërbimi civil” dhe Udhëzimit nr. 1, datë 02.04.2014, të Departamentit të Administratës Publike, “Për elementët kryesorë proceduralë dhe materialë të ecurisë dhe shqyrtimit të shkeljeve disiplinore”.

X. Vlerësimi i rezultateve në punë

Vlerësimi i rezultateve në punë të nëpunësve civilë është parashikuar në nenin 62, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar. Kjo dispozitë parashikon se vlerësimi i rezultateve në punë është një proces që realizohet çdo 6 muaj. Ndërsa në rastin e vlerësimit të rezultateve në punë në përfundim të periudhës së provës, periudha e vlerësimit është një vit dhe llogaritet nga data e emërimit të nëpunësit civil.

Më tej, në vendimin nr. 109, datë 26.02.2014, i Këshillit të Ministrave, “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”, ndryshuar me vendimin nr. 252, datë 30.03.2016, të Këshillit të Ministrave, janë përcaktuar procedurat që duhet të ndiqen për të vlerësuar nivelin e realizimit të objektivave të vendosura, vlerësimin e sjelljes profesionale të nëpunësit; detyrat e zyrtarëve të përfshirë në procesin e vlerësimit; nivelet e shkallëzuara të vlerësimit si dhe të drejtat e nëpunësit në rastet kur ai nuk është dakord me vlerësimin përfundimtar.

Në kuptim të dispozitave ligjore si më sipër, procesi i vlerësimit të rezultateve në punë është një proces i vazhdueshëm, i cili konsiston në zhvillimin e fazës së planifikimit, në të cilën duhet të identifikohen objektivat kryesore të punës dhe sjelljet profesionale që duhet të përmbushë nëpunësi; zhvillimin e fazës së bisedimeve të ndërmjetme për të vlerësuar progresin e nëpunësit që i nënshtrohet vlerësimit; si dhe në vlerësimin përfundimtar të rezultateve në punë, ku zyrtari raportues, bën një vlerësim të përmbledhur në arritjen e objektivave kryesore të punës për nëpunësin që do të vlerësohet.

Gjatë verifikimit u konstatua se, formularët e vlerësimit të punës janë hartuar sipas formatit të miratuar në Lidhjen nr. 2, pjesë e vendimit nr. 109, datë 26.02.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”, ku janë materializuar të gjitha rubrikat që kanë të bëjnë me të dhënat personale (ndarja A); të dhënat për kontekstin e punës ku identifikohen objektivat e institucionit dhe të njësisë organizative ku bën pjesë nëpunësi (ndarja B); objektivat dhe matësit e performancës, ku duke mbajtur parasysh përshkrimin e punës, bëhet vlerësimi për çdo objektiv (ndarja C); sjellja profesionale, e cila ka të bëjë me saktësinë në punën e kryer dhe realizimin në kohë, punën në grup e marrëdhëniet me kolegët, shpeshtësinë e orëve të punës jashtë orarit, kërkesën për këshillim, trajnim dhe ngritjen profesionale (ndarja Ç); vlerësimi i përgjithshëm i rezultateve në punë ku bëhet një vlerësim i përmbledhur i arritjes së objektivave kryesore të punës nga nëpunësit.

Në zbatim të programit të kontrollit, për të gjithë nëpunësit që në momentin e mbikëqyrjes punonin në pozicione pune të konsideruara pjesë e shërbimit civil, u verifikuan vlerësimet vjetore të rezultateve në punë për vitin 2017.

Duke pasur parasysh katër nivelet e vlerësimit “shumë mirë”, “mirë”, “kënaqshëm” dhe “jo kënaqshëm”, nga verifikimet e kryera, vlerësimi përfundimtar i tyre, paraqitet si më poshtë:

Tabela 1: *Niveli i vlerësimit për gjashtëmuajorin e parë të vitit 2017*

Niveli i vlerësimit përfundimtar	Janar – Qershor 2016			
	Shumë mirë	Mirë	Kënaqshëm	Jo kënaqshëm
Numri i nëpunësve të vlerësuar për çdo nivel	9	56	-	-
Totali	65			

Tabela 2: *Niveli i vlerësimit për gjashtëmuajorin e dytë të vitit 2017*

Niveli i vlerësimit përfundimtar	Korrik – Dhjetor 2016			
	Shumë mirë	Mirë	Kënaqshëm	Jo kënaqshëm
Numri i nëpunësve të vlerësuar për çdo nivel	12	51	1	-
Totali	64			

Konkluzion: Komisioneri vlerëson se, në këtë rast, subjekti i mbikëqyrrur, i ka realizuar procedurat e vlerësimit të rezultateve në punë sipas përcaktimeve të nenit 62, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe vendimit nr. 109, datë 26.02.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”, duke kryer vlerësimin sipas formatit të përcaktuar në Lidhjen nr. 1, të vendimit të sipërcituar.

Nga vlerësimet e dhëna për nëpunësit, konstatohet se ata janë vlerësuar me 2 nivele të procesit, niveli 1, “Shumë mirë”, niveli 2, “Mirë” dhe vetëm në 1 rast është aplikuar vlerësimi me nivelin 3, “Kënaqshëm”.

Në këto rrethana, detyrë e zyrtarëve të ngarkuar me këtë proces, duke përfshirë këtu subjektet që e realizojnë atë si dhe njësinë përgjegjëse, mbetet që të sjellë sistemin e vlerësimit të punës, sa më objektiv dhe më afër realitetit, duke përdorur të gjithë spektrin e vlerësimeve, edhe atë që përfaqëson nivelin 3, “Kënaqshëm”, si dhe nivelin më të ulët të vlerësimit, “jo kënaqshëm” (4), që përcaktohen në ligj dhe aktin nënligjor.

Realizimi me sukses i këtij procesi ka lidhje me realizimin e detyrave konkrete të nëpunësve, si dhe me zbatimin e procedurave që kërkohen nga ligji dhe aktet nënligjore në këtë rast. Kjo arrihet nëpërmjet trajnimit të të gjithë aktorëve të këtij sistemi, të cilët janë në rolin e nëpunësit autorizues dhe raportues, si dhe disiplinimin e tyre për të mbajtur shënime, për çdo nëpunës civil, sipas afateve ligjore të analizuara më sipër, në pjesën hyrëse të kësaj rubrike.

Sjellim në vëmendje se, vlerësimi i rezultateve në punë për nëpunësit civil, synon të përmirësojë aftësitë profesionale të nëpunësve, si dhe të ndikojë në cilësinë e shërbimit të ofruar prej tyre, për këtë arsye, zyrtarët e përfshirë në procesin e vlerësimit, (*Zyrtari raportues/Zyrtari kundërfirmues/Zyrtari autorizues*), duhet ta përfundojnë secilën periudhë të vlerësimit, brenda afateve të parashikuara në vendimin nr. 109, datë 26.02.2014, të Këshillit të Ministrave, “*Për vlerësimin e rezultate në punë të nëpunësve civilë*”, të ndryshuar. Në pikën 12, shkronja “b”, të këtij vendimi është parashikuar që për 6 mujorin e parë të vitit vlerësimi realizohet në periudhën 1-15 korrik dhe për 6 mujorin e dytë të vitit në periudhën 1-15 janar. Më tej në pikën 18 është përcaktuar se “*Jo më vonë se 15 ditë nga data e përfundimit të procesit të vlerësimit të rezultateve në punë, njësia e burimeve njerëzore e institucionit detyrohet të përfshijë në Regjistrin Qendror të Personelit formularin e vlerësimit për çdo nëpunës civil*”.

Në këtë subjekt, nuk konstatohen raste të mosmarrëveshjeve ndërmjet zyrtarëve që realizojnë këtë proces (*Zyrtari raportues dhe/ose Zyrtarëve kundërfirmues dhe autorizues*), lidhur me nivelet e vlerësimit, për shkak të pretendimeve të nëpunësit lidhur me vlerësimin e rezultateve në punë.

XI. Transferimi i përkohshëm dhe transferimi i përhershëm dhe si janë respektuar kërkesat ligjore në këto raste (ristrukturimi dhe ngritja e komisionit përkatës, aktet që materializojnë procesin, si dhe rastet e tjera të transferimit)

Kriteret bazë mbi të cilat duhet të bëhet vlerësimi i ligjshmërisë së procesit të transferimit të nëpunësit civil në një pozicion tjetër të shërbimit civil (*transferim i përkohshëm, arsyet e transferimit, kohëzgjatja e transferimit, transferimi i përhershëm, rastet kur zbatohet transferimi i përhershëm, transferimi në rastin e mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit*), janë përcaktimet e Kreut VIII, “*Transferimi në shërbimin civil*”, dispozitat ligjore nga neni 48 deri në nenin 52, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar; vendimi nr. 125, datë 17.02.2016, i Këshillit të Ministrave, “*Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë*”, si dhe Udhëzimi nr. 1, datë 01.03.2016, i Departamentit të Administratës Publike, “*Për krijimin, funksionimin dhe kompetencat e Komisionit të Ristrukturimit për shkak të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit*”.

Gjatë mbikëqyrjes janë vlerësuar këto rrethana:

- A janë të certifikuar si nëpunës civilë, nëpunësit e riemëruar pas procesit të ristrukturimit të institucionit, në përputhje me kërkesat e nenit 67, pika 3 dhe 6, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar.
- Pozicioni i punës ku ka qenë secili nëpunës para procesit të ristrukturimit dhe pozicioni ku është sistemuar pas tij.
- Përshkrimet e pozicioneve të punës të mbetura pas ristrukturimit dhe vlerësimi i kërkesave të përgjithshme e të veçanta të këtyre pozicioneve, nëse përputhen me karakteristikat personale të nëpunësve që janë riemëruar aktualisht në këto pozicione.
- Aktet e lirit të nëpunësve të cilëve u është shkurtuar pozicioni i punës dhe aktet e riemërimit të nëpunësve të mbetur pas ristrukturimit, që plotësojnë kërkesat e veçanta dhe të përgjithshme për pozicionin e ri të punës të krijuar rishtas apo ristrukturuar, sipas përshkrimeve të reja.

Nisur nga përmbajtja e nenit 50, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, Vendimit nr. 142, datë 12.03.2014 “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, i ndryshuar, të Këshillit të Ministrave, rezulton se është njësia përgjegjëse, në këtë rast, Departamenti i Administratës Publike, subjekti që drejton gjithë procesin e ristrukturimit nga ana ligjore.

Gjatë mbikëqyrjes në institucionin e Shërbimit të Provës, u konstatua se, njësia përgjegjëse pas miratimit të strukturës së re ka ndjekur procedurat në përputhje me ligjin, pasi në tërësi, janë respektuar kërkesat e dispozitës së përmendur më sipër, apo të akteve nënligjore që rregullojnë institutin e ristrukturimit.

Pas hyrjes në fuqi të strukturës dhe organikës së miratuar me Urdhrin e Kryeministrit nr. 55, datë 20.04.2017, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Shërbimit të Provës”, nga ana e njësisë përgjegjëse (DAP), është nxjerrë akti për krijimin e Komisionit të Ristrukturimit, me Urdhrin nr. 05, datë 30.01.2018, “Për krijimin e Komisionit të Ristrukturimit në kuadër të ristrukturimit të Shërbimit të Provës”, me përbërjen si vijon:

- Punonjësja *****, “Specialist në Sektorin e Politikave dhe Procedurave të Rekrutimit”, në Drejtorinë e Politikave dhe Zhvillimit në Fushën e Menaxhimit të Shërbimit Civil, në Departamentin e Administratës Publike – Kryetar;
- Punonjësja *****, Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Drejtësisë, - Anëtar;
- Punonjësi *****, Drejtor i Drejtorisë së Inspektimit dhe Shërbimeve Komunitare, në Drejtorinë e Përgjithshme të shërbimit të Provës – Anëtar.

Komisioni është kujdesur që të respektohen kërkesat ligjore në përbërjen e tij, i cili, bazuar në pikën 7, të nenit 50, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, ka të drejtë të propozojë sistemimin dhe trajtimin financiar për të gjithë nëpunësit të cilët do të largohen për shkak të ristrukturimit, duke krahasuar përshkrimin e punës, kërkesat specifike, si dhe çdo kërkesë tjetër që rrjedh nga dispozitat ligjore dhe aktet nënligjore që rregullojnë këtë rast, për çdo pozicion që nuk ekziston më. Në këtë rast ka qenë në vëmendjen e njësisë përgjegjëse, Udhëzimi nr. 1, datë 01.03.2016, i Departamentit të Administratës Publike, “Për krijimin, funksionimin dhe kompetencat e komisionit të ristrukturimit për shkak të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit”, ku përcaktohen qartë rregullat e përgjithshme për krijimin dhe funksionimin e këtij mekanizmi.

Në realizimin e këtij procesi, Komisioni i Ristrukturimi ka marrë parasysh përputhshmërinë e të dhënave individuale të nëpunësve me kërkesat e posaçme të vendeve të punës të ristrukturuara apo të krijuara, si dhe vjetërsinë në punë në pozicionin aktual, kjo e bazuar edhe në përshkrimet e punës, të cilat janë dërguar në sistemin online, pranë Departamentit të Administratës Publike, sipas formularit të përcaktuar nga dispozita ligjore, por ende nuk janë materializuar në formën e kërkuar nga ligji.

Në zbatim të pikës 7, Kreu II, “Transferimi për shkak të mbylljes dhe ristrukturimit të Institucionit” të Vendimit nr. 125, datë 17.02.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për transferimin

e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë”, Komisioni i ristrukturimit duhet që brenda 15 ditëve nga data e ristrukturimit, të bëjë propozimet përkatëse.

Konkretisht, Komisioni i Ristrukturimit për Shërbimin e Provës, pasi ka marrë në shqyrtim dokumentacionin e administruar lidhur me procesin e ristrukturimit, strukturën ekzistuese dhe strukturën e re të institucionit, të dhënat e nëpunësve civilë, vendet e të cilëve janë prekur si pasojë e ristrukturimit (dosjet individuale), kriteret specifike të vendeve të lira apo të krijuara/prekura si pasojë e ristrukturimit, ka vlerësuar mundësitë për transferimin e përhershëm të nëpunësve civilë në strukturat organizative të Shërbimit të Provës, për të cilat nuk ka ndryshime, i ka dërguar propozimet përkatëse DAP në cilësinë e Njesisë Përgjegjëse.

Para momentit të ristrukturimit, organizimi dhe funksionimi i Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Provës, mbështetej në Urdhrit nr. 100, datë 21.02.2014, të Kryeministrit, “*Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Shërbimit të Provës*”. Sipas kësaj strukture, numri i punonjësve të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Provës përfshirë edhe 22 zyrat vendore ishte gjithsej **134** veta.

Pas hyrjes në fuqi të strukturës dhe organikës së re, sipas Urdhrit nr. 55, datë 20.04.2017, “*Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Shërbimit të Provës*”, procesi i ristrukturimit është shoqëruar me rritje të numrit total të punonjësve nga **134** në **148**, përfshirë këtu edhe rritje të numrit të nëpunësve civilë, ndryshim në emërtesa të drejtorive/sectorëve, si dhe ndryshime në kategorinë e pagave.

Me aktin nr. 282 prot., datë 08.02.2018, Komisioni i Ristrukturimit, ka vendosur t`i propozojë DAP mundësinë për transferimin e përhershëm të **13 nëpunësve civilë**, në pozicionet e reja të krijuara pas ristrukturimit (*në total ka një rritje prej 14 pozicione pune, por 1 vend pune i përket funksioneve administrative*). Në vijim të kësaj analize, me aktin nr. 1353 prot., datë 26.02.2018, DAP, në cilësinë e njesisë përgjegjëse, pasi ka marrë në shqyrtim propozimet e Komisionit të Ristrukturimit të Shërbimit të Provës, ka vendosur transferimin e përhershëm të **13 nëpunësve civilë**.

Nga verifikimi i dokumentacionit, rezulton se, nëpunësit në mënyrë shkresore kanë dhënë dakordësinë e tyre për transferimin dhe nuk ka asnjë rast refuzimi në lidhje me vendimin e transferimit të nëpunësve, si rezultat i ristrukturimit, sikurse parashikohet në dispozitat ligjore. Vendimi përfundimtar i marrë nga njësia përgjegjëse, “*Transferim për shkak të ristrukturimit të institucionit*”, si dhe deklarata e nëpunësit të transferuar që shpreh dakordësinë lidhur me transferimin, janë të administruara në dosjen e personelit të çdo nëpunësi civil.

Gjithashtu, gjatë mbikëqyrjes në institucionin e Shërbimit të Provës, u konstatuan edhe **2 raste** të tjera të transferimit të përhershëm dhe **1 rast** të transferimit të përkohshëm, për shkak të riorganizimit të Këshillit të Ministrave. Konkretisht, bëhet fjalë për punonjësit:

✓ **2 raste** transferime të përhershme

- *****, në pozicionin e punës, “*Drejtore në Drejtorinë e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse*”, me shkresën e Departamentit të

Administratës Publike me nr. 6576/100 prot., datë 10.01.2018, është transferuar në kuadër të ristrukturimit të ministrive.

- *****, në pozicionin e punës, “*Drejtor në Drejtorinë e Mbikëqyrjes Elektronike*”, me shkresën e Departamentit të Administratës Publike me nr. 6499/75 prot., datë 04.12.2017, është transferuar në kuadër të ristrukturimit të ministrive.

✓ **1 rast transferim i përkohshëm**

- *****, në pozicionin e punës, “*Specialiste në Zyrën vendore të Shërbimit të Provës, Tiranë*”, me shkresën e Departamentit të Administratës Publike me nr. 5652/1 prot., datë 20.11.2017, është transferuar përkohësisht nga pozicioni i punës, “*Specialiste në Zyrën vendore të Shërbimit të Provës, Lushnje*”.

Konkluzion: Në lidhje me këtë aspekt të administrimit të burimeve njerëzore, Komisioneri vlerëson se:

- Ngritja e Komisionit të Ristrukturimit dhe transferimi i nëpunësve civilë, pozicionet e të cilëve janë prekur si rrjedhojë e ristrukturimit të administratës së Shërbimit të Provës, janë kryer në përputhje me përcaktimet e nenit 50, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, si dhe parashikimet e Kreut III, të vendimit nr. 125, datë 17.02.2016, të Këshillit të Ministrave, “*Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë*”, si dhe në respektim të procedurave të Udhëzimit nr. 3, datë 14.04.2014, të Departamentit të Administratës Publike, “*Për krijimin dhe kompetencat e komisionit të ristrukturimit për shkak të mbylljes apo ristrukturimit*”.
- Procedura e ndjekur nga Komisioni i Ristrukturimit, duke analizuar strukturën dhe organikën e re të miratuar për administratën e Shërbimit të Provës, si dhe strukturën dhe organikën e vjetër, është në përputhje me ligjin, pasi ka shqyrtuar mundësinë e sistemimit të çdo nëpunësi civil në vendet e lira ekzistuese. Në realizimin e këtij procesi, Komisioni i Ristrukturimit ka marrë parasysh përputhshmërinë e të dhënave individuale të nëpunësve me kërkesat e posaçme të vendeve të punës të ristrukturuar apo të krijuar, si dhe vjetërsinë në punë në pozicionin aktual.
- Nëpunësit civilë të përfshirë në ristrukturim, në asnjë rast nuk e kanë refuzuar vendimin përfundimtar të transferimit në kuadër të ristrukturimit, ç`ka provohet me aktet e administruara në dosjet personale të punonjësve dhe nuk konstatohet asnjë rast i lirimit nga detyra për shkak të ristrukturimit.

XII. Administrimi i Dosjeve të personelit si dhe i Regjistrit Qendror i Personelit

a. Dosja e Personelit

Në zbatim të programit, u verifikuan dosjet e personelit për të parë nëse ato janë krijuar dhe administruar në përputhje me përcaktimet e nenit 17, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin*”

civil”, i ndryshuar dhe sipas kërkesave të Vendimit nr. 117, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”.

Nga këqyrja e akteve të administruara në dosjen individuale të çdo nëpunësi civil, u konstatua se duhet të ishin të përfshira dokumente me të dhënat personale të karakterit teknik, profesional, si dhe të dhëna të tjera sipas Lidhjes nr. 1 dhe 2, bashkëlidhur aktit nënligjor, që rregullon në mënyrë specifike këtë aspekt.

Më konkretisht, u konstatua se, në çdo dosje janë të administruara dokumentet e identifikimit (fotokopje e pasaportës); dokumente që tregojnë për gjendjen civile (certifikata e gjendjes familjare); dokumente që vërtetojnë edukimin arsimor (diploma e shkollës së lartë); dokumente që vërtetojnë momentin e fillimit të marrëdhënies së punës (akti i emërimit); akte që tregojnë për nivelin e kualifikimit (certifikata kualifikimi), si dhe aktet që provojnë procesin e deklaramit të statusit të punësimit. Por, nga verifikimi i dosjeve të personelit u vërejtën edhe mangësi të lidhura me mungesën e raportit mjeko ligjor dhe vërtetimin e gjendjes gjyqësore (*dëshmi penaliteti*). Në mënyrë të hollësishme këto akte janë materializuar në **aneksin nr. 2** “Respektimi i kërkesave të përgjithshme, sipas nenit 21 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, për punonjësit që janë të emëruar në pozicione pune pjesë e shërbimit civil, deri në datën 26.02.2014, si dhe të punonjësve që janë aktualisht në pozicione pune pjesë e shërbimit civil”, që është pjesë përbërëse e këtij raporti.

Konstatohet se dosjet individuale të nëpunësve janë të sistemuara, ruhen në kushte të përshtatshme në ambientet e institucionit dhe administrohen nga Specialisti i Burimeve Njerëzore, i cili është nëpunësi përgjegjës për menaxhimin e burimeve njerëzore, në kuptim të Kreut I, pika 4, të vendimit nr. 117, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”.

Nga grumbullimi i të dhënave konstatohet se, në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit të Provës, në momentin e mbikëqyrjes, për 136 pozicionet e punës në shërbimin civil, konstatohet se **67** pozicione pune të shërbimit civil do të vlerësohen të plotësuara në kuptim të ligjit, të cilat ndahen si më poshtë:

- ✓ 28 nëpunës civil janë të gjinisë femërore.
- ✓ 39 nëpunës civil janë të gjinisë mashkullore.
- Moshë mesatare për femrat është rreth 35 vjeç.
- Moshë mesatare për meshkujt është rreth 40 vjeç.
- Moshë mesatare në total është rreth 38 vjeç.

Për sa i përket arsimit të nëpunësve të institucionit të Shërbimit të Provës, rezultojnë të kenë diplomë të studimeve të larta universitare, të marra nga Universitetet Publike dhe Private të Republikës së Shqipërisë dhe nga Universitetet e huaja, nga të cilat:

- ✓ **46** nëpunës zotërojnë diplomë të Universiteteve Publike, në Republikën e Shqipërisë
- ✓ **20** nëpunës zotërojnë diplomë të Universiteteve Private, në Republikën e Shqipërisë

- ✓ 1 nëpunës zotëron diplomë të Universiteteve të Huaja.

Konkluzion: Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, dosjet e personelit nuk janë të plotësuara në përputhje me ligjin dhe njësia e burimeve njerëzore pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Provës duhet t'i plotësojë menjëherë ato duke përfshirë dokumentet me të dhënat personale të karakterit teknik, profesional, si dhe të dhëna të tjera sipas nenit 17, të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar dhe sipas kërkesave të Vendimit nr. 117, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit".

b. Regjistri Qendror i Personelit

Regjistri i personelit është një dokument që duhet të krijohet sipas kërkesave të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar dhe Vendimit nr. 117, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave "Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit".

Regjistri Qendror i Personelit si sistemi që ruan dhe përpunon të dhënat elektronike për burimet njerëzore aktive në të gjitha institucionet e administratës shtetërore, është krijuar dhe administrohet nga Departamenti i Administratës Publike.

Institucioni i mbikëqyrur ka akses në sistem dhe e ushtron këtë funksion nëpërmjet specialistit të personelit. Në sistem bëhet plotësimi dhe përditësimi i të dhënave të parashikuara në Lidhjen nr. 3, "Përkufizimi i administruesve dhe përdoruesve të sistemit", që i bashkëlidhet vendimit nr. 117, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit të personelit".

XIII. Disa mangësi të evidentuara në lidhje me menaxhimin e njësisë së burimeve njerëzore dhe niveli i bashkëpunimit me Departamentin e Administratës Publike

Njësitë e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit, si në ato qendrore dhe në institucionet e vartësisë, janë mekanizma që luajnë një rol të rëndësishëm në administrimin e shërbimit civil, rol i cili buron nga përcaktimet specifike të nenit 10, të ligjit për nëpunësin civil, e vijon me kompetencat ligjore të përcaktuara shprehimisht gjatë zhvillimit të procedurave ligjore që parashikojnë dispozitat në vijim të këtij ligji.

Pozicionimi në këtë mënyrë i këtyre njësive, në institucionet e varësisë, i vendos ato përkrah njësive të burimeve njerëzore të ministrisë nga varet institucioni, si dhe Departamentit të Administratës Publike, në procesin e zbatimit të reformave strukturore dhe funksionale, të ndërmarra nga qeveria në kuadër të reformës së përgjithshme në shërbimin civil.

Gjatë ushtrimit të kompetencës për menaxhimin e nëpunësve civilë të institucionit, kjo njësi bashkëvepron dhe bashkërendon punët me Departamentin e Administratës Publike, si dhe me njësitë e tjera pjesë të strukturës së institucionit me qëllim që të sigurohet zbatimi i parimeve të sanksionuara në ligjin e shërbimit civil dhe të respektohen procedurat ligjore për çdo institut të

tij, ndër të cilat, hartimi i planit të nevojave për rekrutim e trajnim të stafit, hartimi i përshkrimeve të punës, vlerësimet e performancës, evidentimin e karrierës së personelit pjesë përbërëse e institucionit, etj.

Në analizë të strukturës organizative të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Provës, duke vlerësuar rolin e rëndësishëm që ka ky institucion, për shkak të fushës specifike ku ai vepron, rezulton se në përbërjen e strukturës së tij, është krijuar njësi e menaxhimit të burimeve njerëzore, me emërtesën, *Spektori i Shërbimeve Mbështetëse & Çështjeve Ligjore*” pranë Drejtorisë së Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse.

Konstatohet se, gjatë periudhës 2014-2017, ky sektor gjithmonë është i organizuar me 2 pozicione pune, *“Specialist në Sektorin e Shërbimeve Mbështetëse & Çështjeve Ligjore”*, pranë Drejtorisë së Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, të cilët kryejnë detyrat e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit.

Duke u nisur nga konstatimet e grupit të mbikëqyrjes, rezulton se në aspekte të rëndësishme të administrimit të shërbimit civil, njësi e burimeve njerëzore nuk i ka zbatuar detyrimet ligjore, që i ngarkon ligji nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, si dhe aktet nënligjore që kanë dalë në zbatim të tij. Ndër të tjera, ajo ç`ka vlen të theksohet më shumë, është fakti se, megjithëse DAP ka konstatuar pavlefshmërinë absolute, për një numër të konsiderueshëm të akteve të emërimit, për disa raste të përmendura në përmbajtjen e raportit, përsëri në këtë institucion ka vazhduar e njëjta situatë në kundërshtim me ligjin, që përfaqëson emërimet të punonjësve nga titullari i institucionit, duke mos zbatuar procedurat e nenit 23, të ligjit në fjalë.

Nga gjithë dokumentacioni i administruar gjatë procesit të mbikëqyrjes, pavarësisht se janë evidentuar materiale shkresore sinjalizuese nga njësi e burimeve njerëzore në institucion, për të informuar DAP, në lidhje me situatën e paligjshme, me qëllim që të merreshin masat e nevojshme për rivendosjen e ligjshmërisë, ish-titullari i institucionit (*ish-Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit të Provës, ******) nuk ka reaguar, duke e penguar punën e njësisë së burimeve njerëzore.

Në këtë moment, duke mos anashkaluar përgjegjësinë e njësisë së burimeve njerëzore, duhet të evidentojmë edhe faktin se, niveli i përgjegjësisë për shkeljen e ligjit në administrimin e shërbimit civil, është më i lartë tek veprimet e ish-titullarit të institucionit, i cili ka vepruar në kundërshtim të hapur me ligjin dhe ka kryer emërimet në pozicione të shërbimit civil, nëpërmjet akteve të nxjerra prej tij, në kapërcim të kompetencave ligjore, duke mos respektuar procedurat e parashikuara në nenin 23, të ligjit për nëpunësin civil edhe pse në përmbajtjen e tij, përcaktohet në mënyrë të shprehur se, emërimet e kryera në kundërshtim me këtë ligj, janë veprime juridike absolutisht të pavlefshme.

Gjithashtu, edhe Departamenti i Administratës Publike në raportin përfundimtar të inspektimit të zhvilluar në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit të Provës, ka konstatuar veprimet e ish-Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit të Provës, *******, si veprime në kundërshtim me dispozitat ligjore dhe në tejkalim të kompetencave.

Konkluzion: Për të gjitha sa u argumentuan më sipër, Komisioneri vlerëson se, nga ana e institucionit të mbikëqyrur, duhet të kryhet një analizë e plotë e veprimtarisë së aktorëve të

përcaktuar nga ligji për administrimin e burimeve njerëzore në institucion dhe njësisë që mbulon menaxhimin e burimeve njerëzore, të cilët në bashkëpunim me Departamentin e Administratës Publike, për të rregulluar ligjshmërinë në këtë institucion, duhet të përcaktojnë përgjegjësitë konkrete për situatën kaotike të krijuar në menaxhimin e burimeve njerëzore të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Provës.

*
* *

Këto ishin rrethanat e konstatuara nga grupi i punës gjatë procesit të mbikëqyrjes në institucionin e Shërbimit të Provës, në lidhje me zbatimin e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore të dala në bazë e për zbatim të tij.

Aktet administrative që dokumentojnë këtë proces, sipas objektivit të tij, janë materializuar në tabelat e mëposhtme përkatëse për institucionin e Shërbimit të Provës, të cilat janë pjesë përbërëse e këtij raporti.

1. **Aneksi 1** - *“Aktet që materializojnë procesin e njohjes së statusit për nëpunësit që punojnë në pozicione të shërbimit civil, në momentin e mbikëqyrjes*
2. **Aneksi 2** - *“Respektimi i kërkesave të përgjithshme sipas nenit 21 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil, i ndryshuar, për punonjësit që janë të emëruar në pozicione pune pjesë e shërbimit civil (në datën 26.02.2014), si dhe të punonjësve që janë aktualisht në pozicione pune pjesë e shërbimit civil”.*

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA